

Rama pas shpalljes së zisë nga Serbia: Po i fryn si asnjëherë më parë zjarrin të një konflikti të armatosur



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

VAZHDOJNË REAGIMET PËR SULMIN KRIMINAL  
TË 24 SHTATORIT NË VERI TË KOSOVËS

## HOVENIERI: GRUPI I ARMATOSUR NË VERI ISHTE I TRAJNUAR DHE MIROGANIZUAR



Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se ende ka të panjohura lidhur me sulmin e 24 shtatorit në veri ndaj policisë. Ai ka thënë se grupi i armatosur që ka sulmuar policinë ka qenë i trajnuar dhe i organizuar. "Ky ishte një kërcënim për Kosovën dhe për popullin e Kosovës dhe pati pasoja tragjike", ka thënë Hovenieri. Pavarësisht kësaj, ambasadori Hovenier ka deklaruar se ShBA-ja vazhdon të kërkojë nga Kosova dhe Serbia të angazhohen në mënyrë aktive në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja. Ndërsa ambasadori amerikan në Serbi, Christopher Hill, ka thënë se përshkallëzimi i dhunës në veri është një ngjarje tragjike dhe se janë duke i shqyrtuar hapat e mëtejme

PARLAMENTARËT ZVICERANË NËNSHKRUAJNË REZOLUTËN PËR GJYKATËN SPECIALE TË PARAQITUR NGA SHQIPTARI SALI BISLIMI, I CILI NGRE DYSHIME PËR KËTË GJYKATË

## FIGURA MARKANTE TË POLITIKËS ZVICERANE MBËSHITESIN VEPRIMTARIN SALI BISLIMI NË REZOLUTËN PËR GJYKATËN SPECIALE

Figura markante të politikës zvicerane si Gerhard Pfister, Philippe Nantermod, Michel Matter, Charles Juillard, Pointet François, Andreas Meier, Weber Celine, Jacqueline de Quattro, Christa Markwalder, JeanPierre Grin, Alfred Heer, LeoMuller, Zopfi Mathias, Manfred Buhler, Olivier Français dhe shumë të tjerë janë

duke e mbështetur veprimtarin Sali Bislimi në rezolutën që ka paraqitur në parlamentin zviceran për Gjykatën Speciale. Qëllimi i saj është për t'i kërkuar qeverisë zvicerane kujdes për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm për ish-presidentin Hashim Thaçi dhe të tjerët që po mbahen në paraburgim në Hagë për gati tri vjet



### AKTUALE



GJYKIMI I LIDERËVE TË UÇK-së,  
SPECIALJA VAZHDON T'I DËGJOJË  
DËSHMITARËT NË SEANCA TË  
MBYLLURA F. 3

HARADINAJ KËRKON HETIM  
NDËRKOMBËTAR PËR SULMIN E 24  
SHTATORIT NË VERI F. 2

RADOJÇIQI, PJESË E GRUPIT  
KRIMINAL QË SULMOI POLICINË  
NË VERI F. 5

'MASAKRA E ABRISË, NJË NGA  
EMRAT E GJENOCIDIT SERB MBI  
SHQIPTARËT' F. 3

### EKONOMI



BQK-ja: DERI NË FUND TË  
KORRIKUT DIASPORA DËRGOI NË  
KOSOVË RRETH 754 MILIONË EURO  
F. 8

RRITET PËR 18 PËR QIND NUMRI I  
PËRFITUESVE NGA SKEMA  
E PENSIONEVE TË MOSHËS F. 8

### SPORT



KATËR NDESHJE EVROPIANE TË  
HENDBOLLIT ZHVILLOHEN NË  
KOSOVË F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht -Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
+389 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Deputeti gjerman: Vuçiqi e ka gënjeshtër element qendror të veprimeve

BERLIN, 26 SHTATOR - Deputeti i Bundestagut gjerman, Thomas Hacker, ka reaguar ndaj pretendimeve të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, se në Kosovë “po kryhet spastrim etnik”. Hackeri ka thënë se, fatkeqësisht, Vuçiqi e ka

gënjeshtër element qendror të veprimeve të tij. Më tutje, ai ka thënë se Lista Serbe duhet t'i dënojë ngjarjet e fundit dhe të tregojë se është e gatshme të jetë partnere konstruktive. “Fatkeqësisht, gënjeshtria është një element qendror i

veprimeve të presidentit Vuçiq. Akuza për spastrim etnik në Kosovë është thellësisht e rreme. Lista Serbe duhet t'i dënojë ngjarjet e fundit dhe të tregojë se është e gatshme të jetë partnere konstruktive”, ka shkruar Hackeri në “X”.



# Rama pas shpalljes së zisë nga Serbia: Po i fryn si asnjëherë më parë zjarrit të një konflikti të armatosur


TIRANË, 26 SHTATOR - Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, ka shprehur shqetësimin e tij për veprimin e Serbisë pas sulmit terrorist ndaj Kosovës.

Ai ka thënë se beson se shpallja e ditës së zisë nga Serbia është “sinjali më i keq që Serbia mund t'i jepte rajonit dhe komunitetit euroatlantik”.

Kryeministri shqiptar ka shprehur bindjen se me këtë veprim Serbia “i fryn si asnjëherë më parë, qysh prej vitit 1999, zjarrit të një konflikti të armatosur!”.

Rama ka kërkuar nga bashkësia euroatlantike ta dënojë Serbinë. “Ky është momenti që Serbia duhet ta ndajë qartë dhe prerë mendjen nëse do të jetë me Evropën dhe botën demokratike të shekullit XXI apo me hijen e vetvetes së fundshekullit XX; me vlerat dhe parimet e Bashkimit Evropian e të komunitetit euroatlantik apo me fantazmat dhe me krimet e të shkuarës së saj të palavdishme të viteve '90”, ka shkruar Rama në “X”.

Po ashti, ai ka kërkuar që edhe BE-ja me ShBA-në ta ndezin alarmin demokratik për ta ndalur përshkallëzimin e situatës në veri të vendit. “Ky është momenti kur Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara duhet ta ndajnë qartë e prerë mendjen nëse do



ta ngrenë në nivelin më të lartë alarmin demokratik për ta ndalur përshkallëzimin e konfliktit në veriun e Kosovës, i cili ka hyrë në fazën e vet më të rrezikshme qysh prej vitit 1999 apo do të vazhdojnë t'i mbajnë

dialogun për normalizim dhe angazhimin e KFOR-it në të njëjtin nivel krejt të pamjaftueshëm tanimë! Kjo e dyta sot është krejt e pakëshillueshme, por nesër mund të bëhet krejt e

pajustificueshme, sepse nesër mund të jetë vonë edhe për të parën! Prandaj apeli i Shqipërisë për miqtë e mëdhenj e aleatët strategjikë të Ballkanit Perëndimor është: Veprimin e sotëm, mos e lini për nesër!”, ka

shkruar Rama, duke i bërë thirrje Kosovës të reflektojë karshi kësaj situatë. “Ky është momenti kur edhe Kosova duhet të reflektojë shumë seriozisht dhe ta ndajë mendjen qartë e prerë nëse do të vazhdojë në kursin e veprimit të shkëputur nga miqtë e saj të pazëvendësueshëm dhe aleatët e saj të padiskutueshëm apo do të veprojë në harmoni e mirëkuptim me komunitetin euroatlantik, për ta arritur qëllimin më madhor në histori pas fitores së luftës e shpalljes së pavarësisë, njohjen përfundimtare si shtet anëtar i këtij komuniteti! Të gjitha rrugët e tjera, përveç kësaj të dytës, janë rrugë iluzionesh me përfundime të dhimbshme, të cilat e largojnë Kosovën nga qëllimi madhor, e zbrazin atë nga shpirti i ardhmërisë dhe e kthejnë në mënyrën më absurde peng të paqes në mes të Evropës, pasi ka dalë fitimtare nga lufta për t'u bërë një vend i lirë evropian”, ka shkruar Rama.

Qeveria e Serbisë ka marrë vendim që sot (e mërkurë) të jetë ditë zie në shtetin serb për shkak të vrasjes së tre personave të armatosur në veri nga ana e Policisë së Kosovës. Ndërsa Lista Serbe ka marrë vendim që për tri ditë me radhë të mbahet ditë zie në komunat me shumicë serbe në Kosovë.

## Haradinaj kërkon hetim ndërkombëtar për sulmin e 24 shtatorit në veri

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kërkuar hetim ndërkombëtar për sulmin e armatosur në veri të Kosovës ndaj policisë, ku ka mbetur i vdekur rreshteri Afrim Bujaku.

Haradinaj ka thënë se ky hetim duhet t'i zbulojë skenarët për destabilizimin e situatës jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajonin e Ballkanit. “Situata e krijuar

si rezultat i përfshirjes së drejtpërdrejtë të Serbisë në sulmet e armatosura të grupeve kriminale në veri kërkon hetim ndërkombëtar. Ngjarjet në veri dhe sulmi terrorist mbi Policinë e Kosovës janë pjesë e skenarit të përgatitur në Beograd. Reagimi i Policisë së Kosovës është përmbushje e detyrës për ta mbrojtur rendin dhe ligjin. Qëndrimi i Qeverisë së Serbisë dhe rreshtimi i saj krahu grupeve kriminale e

paraushtarake është tejet shqetësues në këtë situatë dhe është sinjal i qartë se shteti i Serbisë është përfshirë në sulmet e armatosura të grupeve kriminale në veri. Prandaj në një situatë të tillë është i domosdoshëm një hetim ndërkombëtar për t'i zbardhur skenarët e destabilizimit të situatës jo vetëm në Kosovë, por në gjithë rajonin e Ballkanit”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.





# Gjykimi i liderëve të UÇK-së, Specialja vazhdon t'i dëgjojë dëshmitarët në seanca të mbyllura

HAGË, 26 SHTATOR - Në seancë të mbyllur ka filluar dëshminë dëshmitari i 27-të në gjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë.

Para se dëshmitari të futej në sallë të gjyqimit, kryetari i trupit gjykues, Charles Smith, ka bërë me dije se këtij dëshmitari i është miratuar kërkesa që ta japë dëshminë në seancë të mbyllur. Paraprakisht, të martën ka përfunduar dëshminë dëshmitari i 26-të (me kodin 4644) në sesion privat. Edhe dëshmia e tij është dëgjuar në seancë private.

Gjatë muajit prill ka filluar gjykimi derisa në seancën e 3 prillit, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe mbrojtësi i viktimave kanë paraqitur deklaratimet hyrëse dhe pas leximit të aktakuzës së ndryshuar nga ana e ZPS-së, ish-presidenti Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, si dhe ish-deputeti Rexhep Selimi, u deklaruan të pafajshëm për veprat penale që u vihen barrë.

Më 4 prill mbrojtja e Thaçit, Veselit dhe Selimit kanë dhënë fjalën hyrëse derisa më 5 prill mbrojtja e Krasniqit ka dhënë

fjalën hyrëse.

Më 11 prill ka filluar paraqitja e provave të Prokurorisë, ku dëshmitarja e parë e mbrojtur e Prokurorisë ka dhënë dëshminë e saj më 11, 12, 13 dhe më 17 prill. Më 17 prill ka filluar dëgjimi i dëshmitarit të dytë, po ashtu i mbrojtur, i cili ka vazhduar dhënien e dëshmisë edhe më 18 prill, 19 prill dhe 20 prill, ku ka përfunduar dhënien e dëshmisë edhe dëshmitari i tretë, kurse më 10 maj ka filluar dhënien e dëshmisë dëshmitari i katërt, dëshmia e të cilit përfundoi më 17 maj.

Më tutje, dëshmitari i pestë ka filluar dëshminë më 17 maj dhe e ka përfunduar më 22 maj, ku ka filluar dëshminë dëshmitari i gjashtë, i cili ka përfunduar dëshminë më 23 maj, në të njëjtën ditë me dëshmitarin e shtatë.

Kurse më 12 qershor ka filluar dëshminë e tij dëshmitari i tetë, i cili përfundoi dëshminë e tij më 14 qershor, ndërkaq më 15 qershor ka përfunduar dëshmia e dëshmitarit të nëntë. Më 19 qershor ka përfunduar dëshminë dëshmitari i dhjetë, në ditën ku ka filluar dëshminë dëshmitari i 11-të, i cili e ka përfunduar dëshminë më 20 qershor. E më 10 korrik ka filluar dëshminë dëshmitari i 12-të, i cili ka përfunduar dëshminë



më 11 korrik, në seancën ku ka filluar dëshminë Rrustem Mustafa, ish-komandat i Zonës Operative të UÇK-së në Llap.

Mustafa ka vazhduar dhënien e dëshmisë në seancën e 12, 13, 14, 17 dhe 18 korrikut. Ndërsa dëshmitari i 14-të me radhë, Francis Ladwidge, oficeri britanik që ka shërbyer në Kosovë, ka filluar dëshminë më 18 korrik dhe e ka mbaruar më 19 korrik, ku ka nisur dëshminë dëshmitari i 15-të, i cili e ka përfunduar më 20 korrik.

Kurse më 14 gusht ka filluar dhënien e dëshmisë dëshmitari i 16-të, kurse e ka përfunduar më 16 gusht dhe më 17 gusht ka përfunduar dëshminë dëshmitarja e 17, Dragica

Bozhaniq.

E dëshmia e dëshmitarit të 18-të ka filluar më 28 gusht dhe ka mbaruar më 29 gusht, në ditën kur ka filluar dëshminë dëshmitari i 19-të, i cili përfundoi dëshminë më 30 gusht.

Më 4 shtator ka përfunduar në të njëjtën ditë dëshminë dëshmitari i 20-të, kurse pa masa mbrojtëse, dëshmitari i 21-të, Agim Idrizi, ka filluar të dëshmojë, i cili e ka përfunduar dëshminë më 5 shtator, ku edhe e ka filluar dëshmia e zyrtarit nga organizata ndërkombëtare "Human Rights Watch", Frederick Abrahams, i cili e ka përfunduar më 11 shtator.

Më 11 shtator ka përfunduar edhe dëshmia e dëshmitarit të 23-të,

ndërsa më 12 shtator ka filluar të dëshmojë dëshmitari i 24-t.

Në të njëjtën ditë ka filluar dëshminë dëshmitari i 25-të, Douglas Young, ish-oficer i ushtrisë britanike, i cili ka përfunduar dëshminë më 14 shtator.

Kurse më 25 shtator ka filluar dëshminë dëshmitari i 26-të.

Procesi gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ka filluar më 3 prill të vitit 2023. Ata janë duke u mbajtur në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020. Katërshtja e UÇK-së është deklaruar e pafajshme në raport me akuzat me të cilat është ngarkuar nga ZPS-ja.

## 'Masakra e Abrisë, një nga emrat e gjenocidit serb mbi shqiptarët'

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Të martën është shënuar 25-vjetori i masakrës së Abrisë, ku forcat serbe kishin masakruar 23 anëtarë të familjes Deliu. Kjo masakër është përkujtuar nga përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, pasi ka bërë homazhe në kompleksin e varrezave në Abri të Epërme, në nderim të të vrarëve në masakrën e 26 shtatorit 1998, ka thënë se Masakra e Abrisë mban emrin e gjenocidit serb mbi shqiptarët. "Ata nuk kursyen as fëmijët, as gratë e as të moshuarit, nga mosha tremuajshe deri në 94 vjeç. Nuk kursyen asnjë anëtar të familjes Deliu atë paradite të 26 shtatorit në vitin 1998 në pyjet afër fshatit ku jetonin, në Abri të Drenicës. Të vrarë mizorisht nga afërsia, kjo ngjarje tronditi edhe mediet botërore", ka thënë Konjufca.

Masakra e Abrisë, sipas tij, sjell në vëmendje fushatën ushtarake



gjenocidale të aparatit shtetëror serb mbi popullin shqiptar në Kosovë.

Gjatë homazheve në Abri, Konjufca ka theksuar se drejtësia ende nuk është vendosur në vend për këtë masakër dhe shumë të tjera që ka bërë Serbia në Kosovë. "Asnjëherë nuk duhet të pushojmë së thëni se drejtësia e

munguar është premtim për padrejtësi dhe krim të ardhshëm të synuar dhe këtë shteti serb nuk ka reshtur së konfirmuari përmes akteve të shumta deri më sot", ka deklaruar Konjufca.

Në përvjetorin e 25-të të masakrës në Abri të Epërme të Drenasit, edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin

Kurti, ka përkujtuar 23 të vrarët e familjes Deliu dhe tre dëshmorët e rënë më 26 shtator 1998. Së bashku me ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, dhe me zëvendësministrin e Punëve të Brendshme, Blerim Gashani, Kurti ka bërë homazhe para

varreve dhe ka vënë lule para përmendores së ngritur në nderim të tyre.

Ndërsa kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Serbia ka ekzekutuar fëmijë disamuajsh e pleq mbi 90 vjeç dhe askush nuk është dënua për këtë masakër. "25 vjet nga rënia heroike e luftëtarëve të lirisë, Vesel Demaku, Valdet Xhemajli dhe Afrim Hajdari. Mësuesi me dy nxënësit e tij, që nuk lëshuan pozicionet deri në frymën e fundit, për të mbetur frymëzim trimërie në rrugën drejt lirisë", ka thënë Haradinaj.

Haradinaj, po ashtu, ka kujtuar familjen Deliu e cila ishte ekzekutuar nga forcat serbe. "Po atë ditë në Abri forcat serbe ekzekutuan familjen Deliu, duke mos kursyer askënd, nga foshnja disamuajsh e deri te plaku 94-vjeçar. Ata ishin të pafajshëm, por askush nuk u dënua për vrasjen e tyre! Të paharruar janë ata që sakrifkuan për atdheun! Nderimi për ta do të jetë i përhershëm", është shprehur Haradinaj.

## Ndërron jetë mjeku dhe ish-ushtari i UÇK-së, Shukri Gërxhaliu

Prishtinë, 26 shtator - Ka ndërruar jetë doktori dhe ish-ushtari i UÇK-së, Shukri Gërxhaliu. Gërxhaliu ka

vdekur në moshën 70-vjeçare dhe lajmin për të e kanë dhënë familjarët e tij. Ai ka shërbyer doktor për ushtarët

e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe ka dëshmuar në Hagë për gratë e dhunuara nga forcat serbe

gjatë luftës në Kosovë. Varrimi i të ndjerit do të bëhet sot (e mërkurë) në fshatin Studime të Vushtrisë.







VAZHDOJNË REAGIMET PËR SULMIN KRIMINAL TË 24 SHTATORIT NË VERI TË KOSOVËS

# Hovenieri: Grupi i armatosur në veri ishte i trajnuar dhe mirorganizuar

Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se ende ka të panjohura lidhur me sulmin e 24 shtatorit në veri ndaj policisë. Ai ka thënë se grupi i armatosur që ka sulmuar policinë ka qenë i trajnuar dhe i organizuar. “Ky ishte një kërcënim për Kosovën dhe për popullin e Kosovës dhe pati pasoja tragjike”, ka thënë Hovenieri. Pavarësisht kësaj, ambasadori Hovenier ka deklaruar se ShBA-ja vazhdon të kërkojë nga Kosova dhe Serbia të angazhohen në mënyrë aktive në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja. Ndërsa ambasadori amerikan në Serbi, Christopher Hill, ka thënë se përshkallëzimi i dhunës në veri është një ngjarje tragjike dhe se janë duke i shqyrtuar hapat e mëtejme

EPOKA  
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Jeffrey Hovenier, është deklaruar të martën për sulmimin e armatosur në veri të Kosovës, ku ka mbetur i vdekur rreshteri i policisë, Afrim Bunjaku dhe tre sulmues serbë. Pas takimit me presidenten Vjosa Osmani, Hovenieri ka thënë se ende ka të panjohura lidhur me sulmin e 24 shtatorit. Ai ka theksuar se grupi i armatosur që ka sulmuar policinë nuk përbëhej nga qytetarë të rëndomtë të cilët janë mbledhur spontanisht për t'i

shprehur shqetësimet e tyre. “Ne ende po punojmë për të kuptuar se si dhe kush është përgjegjës dhe pse. Por dua të them, ju keni parë pamjet e pajisjeve ushtarake dhe planet që ishin zhvilluar. Ky nuk ishte një grup i qytetarëve që sponatisht u bënë së bashku për t'i shprehur shqetësimet e tyre. Ky ishte një grup i trajnuar dhe i organizuar. Kjo nënkupton se pas tyre ka një lloj strukture, duke pasur parasysh trajnimin dhe pajisjet. Ne duam që kjo ngjarje të zbardhet dhe ata të mbahen përgjegjës”, ka thënë Hovenieri në një prononcim për medie.

I pyetur nga mediet për videon e publikuar nga ministri i Punëve të

Brendshme, Xhelal Sveçla, ku nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radojčić, shihet në mesin e grupit të armatosur, ambasadori Hovenier ka thënë se e ka parë atë, por nuk mund as ta konfirmojë e as ta hedhë poshtë vërtetësinë e saj. Ai ka thënë se lidhur me rastin e 24 shtatorit ka pasur një koordinim të mirë në mes të Kosovës dhe përfaqësuesve të komunitetit ndërkombëtar. “Ky ishte një kërcënim për Kosovën, për popullin e Kosovës dhe pati pasoja tragjike”, ka thënë Hovenieri.

Po ashtu, ambasadori amerikan është pyetur se çfarë pret nga dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, pas sulmit ndaj policisë në veri. Me këtë rast, Hovenieri ka thënë se pret zbatimin e marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve. “Ju thatë se situata është krejtësisht e ndryshme. Nuk pajtohem. Përdërisa situata vuri në pah sesa të ndjeshme janë rrethanat dhe sa e brishtë është paqja, mendoj se reflekton deri në një masë për punën e rëndësishme që është bërë për t'i normalizuar raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë. ShBA-ja vazhdon të kërkojë nga Kosova dhe Serbia të

angazhohen në mënyrë aktive në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja, jo për të negociuar zotime dhe marrëveshje të reja, sepse e kemi një marrëveshje të mirë dhe një aneks të mirë të zbatimit, por ta arrijmë zbatimin e plotë nga të dyja palët për këtë marrëveshjeje... Ne duam të shohim që marrëveshja e Ohrit të zbatohet plotësisht nga të dyja palët”, ka thënë Hovenieri.

## Hilli për situatën në Kosovë: Po shqyrtohen hapat e mëtejme

Ndërsa ambasadori amerikan në Serbi, Christopher Hill, ka thënë se përshkallëzimi i dhunës në Banjskë të Zveçanit është “një ngjarje tragjike” dhe se po shqyrtohen hapat e mëtejme. “Ne të gjithë duhet ta dënojmë vrasjen e një pjesëtari të Policisë së Kosovës dhe gjithmonë na vjen keq për humbjen e jetës, por duhet ta vazhdojmë procesin politik”, ka thënë Hilli.

Ai ka theksuar se procesi diplomatik duhet të “forcohet” në ditët dhe javët në vijim. Hilli ka marrë pjesë në takimin e përfaqësuesve të shteteve të Quintit dhe shefit të delegacionit

të Bashkimit Evropian me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Por, diplomati amerikan nuk u është përgjigjur pyetjeve të gazetarëve se për çfarë është biseduar me presidentin e Serbisë.

Vuçiqi ka bërë me dije se gjatë takimit me diplomatët ndërkombëtarë kishte kërkuar që misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, “KFOR, të kujdeset për të gjitha çështjet e sigurisë në veri të Kosovës”.

Shtetet perëndimore kanë dënuar sulmin ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit - komunë në veri të Kosovës e banuar me shumicë serbe.

Një grup i armatosur, që sipas autoriteteve përbëhej prej rreth 30 personash, sulmuan Policinë e Kosovës në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator, duke lënë të vrarë rreshterin Afrim Bunjaku. Policia ka njoftuar se tre sulmues të dyshuar janë vrarë gjatë shkëmbimit të zjarrit në manastirin e Banjskës, ku u strehua ky grup i armatosur. Edhe gjashtë persona të tjerë janë arrestuar, sipas autoriteteve të Kosovës. Personave të arrestuar Gjykata Themelore në Prishtinë ua ka caktuar masën e paraburgimit prej 30-ditësh.



## Radojçiqi, pjesë e grupit kriminal që sulmoi policinë në veri

Prishtinë, 26 shtator - Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës (MPB), Xhelal Sveçla, e ka publikuar një video në "Facebook" në të cilën shihet nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radojçiqi, gjatë sulmit kriminal kundër Policisë së Kosovës në veri të vendit më 24 shtator. "Ky në pamjet më poshtë është Milan Radojçiq, nënkryetar i Listës Serbe, po ashtu pjesë edhe e Listës së Zezë të ShBA-së dhe

Mbretërisë së Bashkuar", ka shkruar Sveçla në përshkrimin e videos.

Ndërsa raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, ka reaguar pas videos të publikuar nga ministri Sveçla, ku shihet se pjesë e grupit terrorist ka qenë edhe nënkryetari i Listës Serbe, Milan Radojçiq.

Von Cramon ka etiketuar kryediplomatit e BE-së, Josep Borell, Oliver Varhleyi dhe Ursula

Von Der Leyen, duke i pyetur se kur do ta sanksionojnë Radojçiqin.

Millan Radojçiqi është nënkryetar i Listës Serbe, i cili kërkohet nga autoritetet e Kosovës dhe është në listën e zezë të ShBA-së për "përfshirje në krimin e organizuar ndërkombëtar". Ai kërkohet nga Kosova nën dyshimet se është përfshirë në frikësimin e dëshmitarëve në rastin gjyqësor, i njohur si "Brezovica".



## Policia e Kosovës ka nevojë për përkrahje më të madhe e jo për retorikë politike!

### Reagim i KMDLNj-së:

Në një sulm të strukturave të organizuara kriminale në Banjskë të Zveçanit u vra rreshteri i policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku dhe u plagosë edhe një polic i Kosovës, i cili pas trajtimit u lirua nga spitali. Në të njëjtën kohë u vranë katër sulmues (flitet se numri është më i madh), kurse numri i të plagosurve nuk dihet. Janë arrestuar gjashtë sulmues prej të cilëve dy ishin plagosur dhe trajtuar në QKUK. Rreshteri Afrim Bunjaku ra duke e mbrojtur betimin për ruajtjen dhe mbrojtjen e rendit kushtetues të Kosovës, kurse serbët e armatosur u vranë duke e sulmuar dhe në përpjekje për ta rrënuar rendin kushtetues të Kosovës. Për KMDLNj-në nga aspekti i të drejtave të njeriut është më shumë rëndësi trajtimi i të arrestuarve gjatë arrestimit dhe pasi janë dërguar në mbajtje sikur edhe trajtimi profesional në QKUK për sulmuesit që ishin plagosur. Së paku, deri më tani



nuk ka ndonjë ankesë nga të arrestuarit. Trajtimi i tyre në vazhdim është përgjegjësi e institucioneve përgjegjëse të drejtësisë dhe KMDLNj-ja është e sigurt se ata do të trajtohen sipas ligjeve në fuqi duke respektuar të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria.

KMDLNj-ja shumë herë përmes reagimeve publike ka kërkuar që të përmirësohen kushtet e punës për policët e Kosovës sepse ka vlerësuar se ato janë në shpërputhje me punën që e

bejnë. Policët e Kosovës për shumë vite nuk janë furnizuar me uniforma dhe këpucë, prandaj janë detyruar që uniformat dhe këmbisat t'i dërgojnë në dyqanet ku ngjyrosen rrobat, kurse këpucët, varësisht nga gjendja materiale i kanë blerë vet. Policëve u është hequr shtesa për rrezikshmëri, rrogat deri vonë ishin të ulëta dhe furnizimi me pajisje që janë të domosdoshme për punën e tyre kanë qenë të mangëta. Gjatë disa operacioneve të njëjësve speciale

të policisë ka munguar ushqimi i cilësisë së nevojshme kurse, në disa raste vet banorët kanë dërguar ushqim për policët.

Ndërsa institucionet e Kosovës kanë dështuar të përmbushin detyrimet ndaj një shërbimi shumë specifik që është edhe dhe shtylla kryesore për mbrojtje të rendit kushtetues siç është sigurimi shëndetësor dhe sigurimi i jetës.

KMDLNj-ja në çdo reagim ka kërkuar që policët të kenë sigurim shëndetësor dhe jetësor sikur që e kanë në çdo vend normal. Përveç premtimeve, asgjë nuk është bërë në përmbushjen e këtyre të drejtave që iu takojnë të gjithë qytetarëve kurse, zhveshja e policëve nga këto të drejta, sa normale aq edhe të domosdoshme nuk ka asnjë arsytim logjik.

Përkundër kësaj, Policia e Kosovës ka qenë dhe mbetet institucioni më profesional dhe më i besueshëm në përmbushje të mandatit të saj kushtetues, që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës e deri më tani. Për ta

ruajtur nivelin profesional të Policisë së Kosovës, institucionet e shtetit duhet të krijojnë kushte pune dhe kushte më të mira për jetë për policët e Kosovës e jo që në vend të përmbushjes së këtyre kushteve të ofrojnë një retorikë politike që përdoret vetëm gjatë ngjarjeve të rënda siç ishte rënia në detyrë e rreshterit Afrim Bunjaku.

KMDLNj-ja kërkon nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që të thërrasin një seancë të jashtëzakonshme në të cilën do të diskutohej dhe dalin me një qëndrim që sa më parë që të jetë e mundur të krijohen kushtet për sigurime shëndetësore dhe sigurime jetësore për policët e Kosovës dhe të ndërmarrin veprime tjera për përmirësimin e kushteve për policët e Kosovës, si shtyllë e pazëvendësueshme e ruajtjes dhe funksionimit të shtetit.

KMDLNj-ja bën thirrje publike për përmbajtje nga fjalori nxitës, fjalori i urrejtjes dhe paragjykes dhe në të njëjtën kohë duhet të punohet për uljen e tensioneve.

## BE-ja insiston që sulmuesit në veri të vihen para drejtësisë

BRUKSEL, 26 SHTATOR - Bashkimi Evropian (BE) ka insistuar që përgjegjësit për sulmin ndaj Policisë së Kosovës që ka ndodhur në veri të Kosovës të vihen para drejtësisë dhe të gjitha faktet të verifikohen. Kështu ka thënë në një konferencë për medie zëdhënësi i BE-së për çështje të jashtme dhe siguri, Peter Stano. I pyetur se çfarë roli mund të luajë EULEX-i për të mundësuar komunikimin mes autoriteteve policore në Kosovë dhe atyre në Serbi, pasi ato nuk kanë bashkëpunim direkt, zëdhënësi i BE-së ka thënë se EULEX-i është në terren dhe po bashkëpunon shumë mirë me autoritetet e Kosovës. "EULEX-i është në terren si reaguesi i dytë. Është i angazhuar me kërkesë të Policisë së Kosovës. Bashkëpunimi deri më tash ndërmjet Policisë së

Kosovës dhe EULEX-it është shumë i mirë. Komandanti i EULEX-it është në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesin e lartë të BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, dhe informon për të gjitha hollësitë në terren", ka thënë Stano.

Ai ka përsëritur se hetimet ende po vazhdojnë, porse nuk ka dilemë se përgjegjësit duhet të dalin para drejtësisë. "Hetimet po vazhdojnë dhe ato nuk janë kryer. Ato janë krejtësisht në duart e Policisë së Kosovës, dhe me kërkesë ata asistohen nga EULEX-i dhe KFOR-i. Duhet të vërtetohet se kush i bëri këto sulme terroriste, kush i organizoi, kush qëndron prapa tyre dhe përgjegjësit të dalin para drejtësisë. Sa i përket përgjegjësisë, mosndëshkueshmërisë, qëndrimi i BE-së është i



qartë. Të gjithë përgjegjësit duhet të dalin para drejtësisë dhe këtu nuk ka asnjë dilemë", ka thënë ai.

Në pyetjen se cili do të jetë roli i BE-së për të siguruar që ata që janë në Serbi e që kanë marrë

pjesë në sulme, të mos i ikin drejtësisë, Stano ka thënë se "kontaktet tona me partnerët shkojnë përmes kanaleve përkatëse e jo medieve".

Zëdhënësi i BE-së ka thënë se janë duke i vazhduar aktivitetet e ngjashme diplomatike lidhur me situatën në Kosovë. Ai ka përmendur takimin e së hënës të të dërguarit të posaçëm, Miroslav Lajçak, me zyrtarët e lartë nga ShBA-ja, Gjermania, Franca dhe Italia. "Edhe përfaqësuesi i lartë, Josep Borrell, po ashtu ka qenë në kontakt edhe me liderët në Kosovë dhe Serbi, por edhe me vendet anëtare. Vendet anëtare janë duke e analizuar situatën. Do të ketë takim sot pasdite edhe në Bruksel nga përfaqësuesit e vendeve anëtare ku do të diskutohet për hapat e nevojshëm", ka thënë Stano.



## Tahiri: Kosova e ka vendin në Këshillin e Evropës

Prishtinë, 26 shtator - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka takuar të martën disa juristë nga Këshilli i Evropës, të cilët janë duke qëndruar në Kosovë. Me këtë rast, Tahiri ka thënë se Kosova e ka vendin në Këshillin e Evropës. "Në takim me juristët eminentë, dr. Thomas Markert dhe dr. Sia Spiliopoulou

Akermark nga Këshilli i Evropës, të cilët janë duke qëndruar në vendin tonë për ta vlerësuar vendin tonë në kuadër të aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Në takim theksova se Kosova për nga aspekti legjislativ është vend që ka sistem të avancuar të promovimit të vlera të të drejtave të njeriut,

demokratizimit dhe sundimit të ligjit. Rruga jonë e ndërtimit të shtetit është e bërë në bashkëpunim të plotë me BE-në dhe bashkësinë ndërkombëtare. Në fund konkludova se Kosova e ka vendin në këtë institucion, qytetarët e saj e meritojnë të kenë qasje në instrumentet e Këshillit të Evropës", ka shkruar Tahiri në "Facebook".



# Shefi i BE-së në Kosovë kërkon respektimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara



Prishtinë, 26 shtator - Bashkimi Evropian dhe UNICEF-i prej ditësh kanë hapur fushatën për rritjen e ndërgjegjësimit për barrierat me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara. Në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë është duke qëndruar instalacioni në formë lëmshi përmes të cilit tregohen sfidat me të cilat përballen këto kategori e fëmijëve.

Të martën shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Tomas Szunyogu, ka

vizituar këtë instalacion së bashku me përfaqësues të vendeve anëtare të BE-së dhe shefen e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Nona Zicherman. Me këtë rast, Szunyogu ka theksuar rëndësinë e sigurimit të të drejtave të barabarta për fëmijët me aftësi të kufizuara. "Mendoj se është me të vërtetë e rëndësishme të sigurohen të drejta të barabarta për këta fëmijë, t'i identifikojmë ata herët, t'i lejojmë t'i përdorin të njëjtat sisteme arsimore si fëmijët e tjerë, por edhe t'u sigurohen

atyre hapësira publike dhe mundësi publike. Mendoj se kjo është shumë e rëndësishme. Ne, gjithashtu, duhet të shikojmë në kuadrin legjislativ dhe të kuptojmë se ka nevojë për një ligj të ri, veçanërisht që ka të bëjë me fëmijët me aftësi të kufizuara", ka thënë Szunyogu, duke bërë me dije se instalacioni në formë lëmshi do të shëtisë edhe në komunat e tjera të Kosovës. "Kjo është një fushatë e përbashkët e BE-së dhe UNICEF-it. Po e nisim këtu në Prishtinë, por është

planifikuar të shkojmë nëpër Kosovë, të vizitojmë komuna të ndryshme dhe të ndërgjegjësojmë për të drejtat dhe nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ka një lëmsh simbolik sepse besojmë se motoja e njëjës për fëmijët me aftësi të kufizuara mund ta tërheqë vëmendjen e publikut. Është vërtet një çështje e rëndësishme. Ne besojmë fort për këtë. Pra, le të shpresojmë se kjo fushatë do t'i ndihmojë fëmijët", ka thënë Szunyogu. Fushata avokon për të drejtat e

fëmijëve me aftësi të kufizuara me fokus të veçantë në rritjen e qasjes në hapësirat publike, zgjerimin e disponueshmërisë së shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse dhe luftimin e stigmës dhe diskriminimit ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre.

Ndërsa shefja e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Nona Zicherman, i ka ftuar të gjithë qytetarët t'i bashkohen kësaj fushate, që të bëhet më shumë për fëmijët me aftësi të kufizuara.

## Protestojnë punëtorët teknikë të QKMF-së në Prishtinë, kërkojnë rritje të pagave

Prishtinë, 26 shtator - Punëtorët teknikë të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prishtinë kanë protestuar në shenjë pakënaqësie për

trajtimin e këtyre punëtorëve lidhur me pagat dhe kushtet e tjera.

Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat të Kosovës, Jusuf Azemi,

punëtorët po kërkojnë rritje të pagave 300 euro bruto. Sipas tij, protesta e greva nuk do të ndalen dhe se nëse nuk realizohen kërkesat, mund të ketë lëshim kolektiv të

vendeve të punës. "Punëtorët duan rritje të pagës prej 300 eurosh pagë bruto. Protestat e greva nuk do të ndalen deri te lëshimi kolektiv i vendeve të punës", ka thënë Isufi.







PARLAMENTARËT ZVICERANË NËNSHKRUAJNË REZOLUTËN PËR GJYKATËN SPECIALE TË PARAQITUR NGA SHQIPTARI SALI BISLIMI, I CILI NGRE DYSHIME PËR KËTË GJYKATË

## Figura markante të politikës zvicerane mbështesin veprimtarin Sali Bislimi në rezolutën për Gjykatën Speciale

Figura markante të politikës zvicerane si Gerhard Pfister, Philippe Nantermod, Michel Matter, Charles Juillard, Pointet François, Andreas Meier, Weber Celine, Jacqueline de Quattro, Christa Markwalder, JeanPierre Grin, Alfred Heer, LeoMuller, Zopfi Mathias, Manfred Buhler, Olivier Français dhe shumë të tjerë janë duke e mbështetur veprimtarin Sali Bislimi në rezolutën që ka paraqitur në parlamentin zviceran për Gjykatën Speciale. Qëllimi i saj është për t'i kërkuar qeverisë zvicerane kujdes për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm për ish-presidentin Hashim Thaçi dhe të tjerët që po mbahen në paraburgim në Hagë për gati tri vjet

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

BERN, 26 SHTATOR - Të hënën dhe të martën në parlamentin e Zvicrës janë vënë nënshkrimet nga parlamentarët zviceranë për rezolutën e prezantuar nga shqiptari Sali Bislimi, e cila ka të bëjë për Gjykatën Speciale. Përmes kësaj rezolute të paraqitur nga organizata joqeveritare "Zëri Perëndimor i Kosovës", drejtor i së cilës është veprimtarin Sali Bislimi, njëherësh edhe drejtor i zyrës ligjore First-consulting.ch në Bern, kërkohet nga qeveria zvicerane kujdes për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm për ish-presidentin

Hashim Thaçi dhe të tjerët që po mbahen në paraburgim në Hagë për gati tri vjet.

Bislimi ngre dyshime në këtë gjykatë e për këtë edhe ka paraqitur këtë rezolutë. Deri më tani kjo rezolutë ka marrë përkrahjen e mbi 40 deputetëve të parlamentit të Zvicrës dhe ajo do të jetë në dispozicion të deputetëve zviceranë edhe në ditët e ardhshme.

Bislimi ka bërë me dije se kjo rezolutë po merr mbështetjen e të gjitha figurave markante të politikës zvicerane, si: Gerhard Pfister, Philippe Nantermod, Michel Matter, Charles Juillard, Pointet François, AndreasMeier,



Weber Celine, Jacqueline de Quattro, Christa Markwalder, Jean Pierre Grin, Alfred Heer, Léo Muller, Zopfi Mathias, Manfred Buhler, Olivier Français dhe shumë të tjerë. Ai ka treguar se

nënshkrimet për këtë rezolutë do të vazhdojnë edhe ditëve në vazhdim për të arritur suksesin dhe kujdesin që meriton Kosova, mbi të gjitha çlirimtarët e saj.


Bislimi përmes kësaj rezolute kërkon që të ketë respektim të procedurave gjyqësore dhe një gjykim të drejtë në nivel ndërkombëtar.

Në rezolutë theksohet se çlirimtarët e Kosovës, pavarësia e të cilëve de fakto dhe de jure u njoh menjëherë nga Zvicra, po përballen me një procedurë të rëndë penale. "Në veçanti, ish-presidenti Hashim Thaçi aktualisht ndodhet në paraburgim në Hagë. Procedura i ngjan një njeje të vërtetë gordiane, pasi që në këtë

fazë duket se ndikimet e jashtme politike kundër ish-presidentit Thaçi po ndërhyjnë në mbajtjen e një gjykimi të drejtë. Duket qartë se hetimi i kryer nga drejtësia ndërkombëtare kundër tij sugjeron në mënyrë të arsyeshme një paragjykim dhe vë në masë të madhe në pikëpyetje vërtetësinë e fakteve me të cilat ai akuzohet", theksohet në rezolutën, e cila tashmë ka hyrë në objektin e parlamentit të Zvicrës.

Kjo rezolutë, pasi të kalojë në parlamentin zviceran, dërgohet në qeveri.

Sali Bislimi është një veprimtar i cili jeton dhe vepron në Zvicër. Ka lindur në Topillë të Shtimes, por kontributi i tij për shtetin e Kosovës



është i madh. Ai në mënyra të ndryshme nga Zvicra ka ndihmuar Kosovën. Ai nga Misioni Diplomatik Paqe dhe Prosperitet është nderuar me dekoratën "Ambasador i Paqes". Gjithashtu, Sali Bislimi nga presidenti i atëhershëm i Kosovës, Hashim Thaçi, është nderuar me "Urdhër të Pavarësisë". Urdhri i Pavarësisë u jepet personave që kanë dhënë kontribut të lartë për pavarësinë e Kosovës.



## BQK-ja: Deri në fund të korrikut diaspora dërgoi në Kosovë rreth 754 milionë euro

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka publikuar statistikat financiare për ndërmjetësit financiarë, kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale dhe remitencat për muajin gusht 2023. Sa iu përket remitencave, BQK-ja ka bërë me dije se deri në fund të muajit korrik të këtij viti diaspora ka dërguar në Kosovë rreth 754 milionë

euro. "Remitancat deri në fund të korrikut 2023 arritën vlerën rreth 754 milionë euro, që paraqet rritje prej 12-përqindësh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, ku vetëm në muajin korrik ishin 118.8 milionë euro. Remitancat kryesisht vijnë nga shtetet e BE-së rreth 70 për qind e gjithsej remitancave, prej të cilave kryeson

Gjermania me 38.1 për qind dhe ndiqen nga Zvicra me 17.6 për qind dhe ShBA-ja rreth 7.5 për qind. Sipas vlerësimeve preliminare, remitancat për muajin gusht ishin rreth 142.2 milionë euro. Prurjet më të mëdha edhe gjatë këtij muaji kanë qenë përmes IFJB 42 për qind, kanalet e tjera 40 për qind, ndërsa përmes bankave 19 për qind", ka njoftuar BQK-ja.



## Përplasjet e republikanëve dhe demokratëve për buxhetin rrezikojnë mbylljen e pjesshme të Qeverisë së ShBA-së

WASHINGTON, 26 SHTATOR - Qeveria amerikane është në prag të mbylljes së pjesshme nëse Dhoma e Përfaqësuesve, e kontrolluar nga republikanët, nuk pajtohet për buxhetin federal për vitin e ri fiskal që fillon më 1 tetor.

Disa republikanë madje kanë kërcënuar me shkarkimin e kryetarit të Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy. Në më pak se një javë, qeveria amerikane rrezikon të mbyllet pjesërisht, nëse Kongresi nuk arrin një marrëveshje për shpenzimet federale, çfarë ka nxjerrë në pah krisjet brenda republikanëve.

Një grup konservatorësh të vijës së ashpër kanë kërcënuar me shkarkimin e kryetarit McCarthy pas aritjes së një kompromisi për shpenzimet midis tij dhe presidentit Joe Biden në fillim të këtij viti për ta shmangur dështimin për t'i paguar borxhet qeveritare. "Po ndodh për shkak se ligjvënësit republikanë nuk mund të bien dakord as mes tyre. Duhet të kujtojmë se McCarthy dhe presidenti Biden arritën një marrëveshje të vështirë për të gjitha palët. E tillë ishte për agjencinë tonë. Nënkupton shkurtimin e disa programeve që donim të realizonim, disa fonde do të përdorehin për përmirësimin e rrugëve, urave dhe aeroporteve. Por ne e pranuan marrëveshjen e bërë në fillim të vitit. Po kërkojmë



që republikanët ta respektojnë këtë marrëveshje", ka thënë sekretari i Transportit, Pete Buttigieg.

I njëjti grup republikanësh dëshiron shkurtime të thella për shpenzimet e brendshme si dhe për mbështetjen amerikane për

Ukrainën në luftën e saj kundër agresionit të Rosisë, raporton "VOA".

Bideni ka pritur javën e kaluar presidentin ukrainas Volodymyr Zelenskyy në Shtëpinë e Bardhë pas fjalimeve që ata kanë mbajtur

në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork. Ai është zotuar për vazhdimin e mbështetjes së palëkundur për Ukrainën. "Populli i Ukrainës është i çelikosur për këtë betejë dhe Shtetet e Bashkuara do të

vazhdojnë të qëndrojnë me ju", ka thënë Bideni.

McCarthy ka përfshirë 300 milionë dollarë fonde për Ukrainën në një projektligj për shpenzimet e mbrojtjes, që duhet të miratohet nga Dhoma e Përfaqësuesve. Por nuk ka gjasa që ta marrë miratimin e republikanëve të vijës së ashpër. "Do të jem me zotin McCarthy çdo ditë dhe sigurisht që kemi ende kohë, por ai është në një pozitë shumë të vështirë, sepse kundërshtarët vazhdojnë t'i thonë që të mos i paraqesë për votim projektligjet dypartiake, mos t'i përdorë votat e demokratëve për ta shmangur mbylljen. Por ata po përdorin votat e demokratëve për ta shkaktuar mbylljen. Ky grup republikanësh po voton me Nancy Pelosin kundër projektligjeve republikane që kanë dalë për votim", ka thënë ligjvënësi republikan Mike Turner.

Partia e McCarthyit ka një shumicë të vogël në Dhomën e Përfaqësuesve. Mjafton kundërshtimi nga pesë republikanë për ta bllokuar çdo legjislacion që përpiqet të miratojë shumica.

Ligjvënësit do të përpiqen përsëri ta shmangin një mbyllje të pjesshme të qeverisë, e cila mund të ndodhë pas mesnatës së një tetorit nëse ligjvënësit dështojnë të pajtohen qoftë edhe për një financim afatshkurtër.

## Rritet për 18 për qind numri i përfituesve nga skema e pensioneve të moshës

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Është rritur për 18 për qind numri i përfituesve nga skema e pensioneve bazike të moshës, ndërsa numrit të familjeve përfituese nga skema e ndihmës sociale ka rënë për 15 për qind.

Kështu është thënë në raportin "Statistikat e Mirëqenies Sociale, gusht 2023", paraqitur nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), duke shtuar se deri në këtë periudhë kanë përfituar 20 mijë e 810 familje nga skema e ndihmës sociale. "Në muajin gusht 2023, nga skema e ndihmës sociale

kanë përfituar 20 810 familje me gjithsej 81 903 anëtarë që, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak që ishte 24 627 familje me gjithsej 97 124 anëtarë, vërehet një rënie e numrit të familjeve përfituese nga kjo skemë për 3 817 persona ose 15.5 për qind", ka njoftuar ASK-ja. Sipas ASK-së, rritje të përfituesve ka pa pasur edhe te personat paraplegjik dhe tetraplegjik. "Në muajin gusht 2023, krahasuar me muajin gusht 2022, kishte rritje të përfituesve nga skema e pensioneve bazike të moshës me 18.1 për qind,

skema për pensionet e personave paraplegjik dhe tetraplegjik me 16.1 për qind, skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara me 14.7 për qind dhe skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) me 10.7 për qind. Skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara me 7.1 për qind, skema e pensioneve kontribut-paguese të moshës me 5.6 për qind, skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/1991 deri në vitin shkollor 1998/1999 me



5.3 për qind, skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK)

me 2.8 për qind dhe skema për veteranët e luftës me 0.2 për qind", ka njoftuar ASK-ja.



# Gjeopolitika e Eduardo Galeano: Tri gjysmë të vërteta për shkrimtarin amerikano-latin



Le ta fillojmë me tri provokime: Galeano nuk quhej Galeano; Galeano nuk ishte shkrimtar politik; Galeano nuk ishte i majtë. Paralajmërojmë se nuk flitet për tri të vërteta, por për tri gjysmë të vërteta, por që siç do ta shpjegojmë, janë të pakundërshtueshme.

Le ta fillojmë nga emri. Eduardo Germán María Hughes Galeano, por që firmoste thjesht si Eduardo Galeano. Nuk ishte thjeshtëzim, pasi në këtë rast dë të duhej të firmoste Eduardo Hughes, sipas mbiemrit nga babai. Nuk ishte as emër arti, pasi Galeano ishte mbiemri nga nëna. Në onomastikën spanjishtfolëse praktikisht merret ligjërisht mbiemri i dyfishtë, nga babai e nga nëna, dhe është normale të vendoset edhe më shumë se një emër pagëzimi. Por zakonisht përdoren emrin i parë dhe mbiemri i parë atëror. Fidel Castro, jo Fidel Alejandro Castro Ruz. Ernesto Guevara i thirrur Che, jo Ernesto Guevara de la Serna. Hugo Chávez, jo Hugo Rafael Chávez Frías. Kush i përdor të dy, kapet veçanërisht pas një nëne me një mbiemër të shquar. Ose ka një mbiemër atëror banal, që bëhet më i individualizueshëm falë

shtesës së mbiemrit mëmësor: Gabriel García Márquez, Mario Vargas Llosa. Ose ka babain që i ka vënë vetë emrin e tij dhe, për pasojë, mbiemri i dytë shërben për t'u dalluar: Eduardo Frei Ruiz-Tagle, President i Kilit nga 1994 deri më 2000, djali i Eduardo Frei Montalva, President i Kilit nga 1964 deri më 1970.

Kush përdor vetëm mbiemrin mëmësor, nga Pablo Ruiz Picasso tek José Luis Rodríguez Zapatero, përgjithësisht përveçse ka një mbiemër të parë banal, ka pasur edhe ndonjë problem me figurën atërore. Pse Galeano ka preferuar të njihet me mbiemrin gjenovas të nënës sesa me atë uellsian të babait?

Lidhur me motivin e kësaj zgjedhjeje, latinoamerikanët e shumë që ia kanë rrëfyer këtë veçanti autorit të këtyre radhëve kanë shprehur gjithmonë të njëjtin opinion: "Si mundet një denigrues i imperializmit anglo - sakson të firmoste me?"

Në fak, Galeano është autori i "Las venas abiertas de América Latina". Domethënë i librit që më 19 prill të vitit 2009, në Samitin e Amerikave të Port of Spain, Chávez ia dhuroi Barack Obama herën e parë që e takoi për ta goditur lidhur me

paudhësitë historike të Shteteve të Bashkuara në "oborrin e shtëpisë": një dhuratë që e bëri të kapërcejë bujshëm, brenda një dite, nga vendi i 54925-të në vendin e 2-të e klasifikimit Amazon.

Është edhe një libër që Plinio Apuleyo Mendoza, Carlos Alberto Montaner dhe Álvaro Vargas Llosa më 1996 në librin e tyre po aq të famshëm të idiotit të përsosur latinoamerikan e futën në listën e tyre të "Dhjetë librave që mallëngjyen idiotin latinoamerikan". Duket si një deingrim, por duke parë se kush e bën dhe tonet, mund edhe të konsiderohet një lloj elozhi po aq i rëndësishëm sa edhe dhurata e Chávez.

"Nuk ekziston kompendium më i mirë i gabimeve, arbitraritetit apo i budallallëqeve të thjeshta që popullojnë kokët e vogla e radikalëve tanë më të çartur. Veç kësaj, nuk ka një libër të zhanrit të tij që të ketë pasur po kaq botime, përkthime dhe lavdërime. Domethënë nuk njihet në gjuhën tonë një vepër si puna e saj që të meritojë të konsiderohet si bibla e idiotit latinoamerikan ose, nga një këndvështrim tjetër, si fejtoni i madh i mendimit politik. Përhumbësisht lirik, titulli është një

tregues elokuent i asaj që vjen më pas: Amerika Latine është një kontinent inert, në gjendje të fikëti midis Atlantikut dhe Paqësorit, të cilit perandoritë dhe maskarenjtë në urdhërat e tyre i thithin gjakun nga damarët, domethënë pasuritë e pafundme natyrore". Montaner e kishte shprehur tashmë një mendim të këtij lloji në një intervistë të 1992, 4 vjet përpara një libri që dukshëm u konceptua shumë përpara kohe si në "antidamar i hapur i Amerikës Latine" eksplisit.

Por Montaner, Mendoza dhe Vargas Llosa junior nuk kontestonin se bëhej fjalë për një libër bindës dhe tërheqës. Paradoksalisht, një goditje më shumë se vdekjeprurëse i kishte ndodhur një vit më parë nga vetë Galeano. Përballë publikut të shastisur të Bienales së II të Librit në Brasilia, ky e përcakttoi si një vepër me "prozë shumë të rëndë", që nëse do të provonte ta rilexonte "se desmayaría". Si të thuash: "një tullë që do kishte rrëzuar përtokë këdo".

Është ky lloj proze jo e mrekullueshme me të cilën Galeano ka çuar në sukses bestsellerë të tjerë të tij si "Kujtesa e zjarrit" apo "Fisnikëri dhe mjerim i

lojës së futbollit". Në rast se ta mohosh stilin është subjektive, gjëja vërtetë e rëndësishme është pranimi i paaftësisë: "Doja të shkruaja një libër ekonomie politike, por tani e kuptoj se nuk e kisha përgatitjen e nevojshme për ta shkruar".

Praktikisht ishte 31 vjeçar dhe e bëri në rreth 90 ditë, edhe pse më pas do ta azhurmonte shumë herë. Por ka mundësi të jetë pikërisht ky sekret i këtij sukcesi. Mendimtarë të tjerë më të strukturuar e kishin përpunuar tashmë "Teorinë e Varësisë", historianë të tjerë kishin tentuar një histori të kontinentit, por duhej pikërisht jovetëdija e një 31 vjeçari të ideologjizuar dhe me kulturë të përgjithshme që të guxonte një ndërmarrje thjeshtëzuese aq titanike duke përdorur një stil në gjendje të kuptohej nga të gjithë.

Mutatis mutandis, ajo që ka bërë Galeano me historinë e Amerikës Latine është shumë e ngjashme me atë që ka bërë Indro Montanelli me historinë e Italisë: një thjeshtëzim i mrekullueshëm dhe arbitrar që me sokëllima kliseshë dhe batutash arrin ta apasionojë me argumentin edhe lexuesin të cilit lënda mund t'i dukej e vështirë. Kështu, lexuesi është apasionuar



vërtet, thellon, studion dhe kupton se pjesa më e madhe e asaj që e ka apasionuar duhej vlerësuar me shumë kujdes.

Por gjithsesi Galeano dhe Montanelli meritojnë njëloj falenderimi. Në këtë kuptim duhet inkuadruar gjysmë e vërteta e dytë që kemi thënë. Ashtu si Montanelli arriti të divulgojë historinë në një mënyrë me të cilën historianët italianë nuk ia kishin arritur pikërisht pse nuk ishte historian, por një gazetar i madh, Galeano arriti të shkruajë një manifest tribotist aq efikas sa të rezultojë i vështirë për t'u imituar nga mendimtarë të tjerë dhe kjo sepse pasioni i vërtetë i tij nuk ishte politika, por futbolli.

Autor librash, por jo romancier i suksesshëm si shumë emra të tjerë të intelektualizmit latinoamerikan që ecin më shumë, intim me protagonistët e bumit pa i qenë pjesë, edhe me suksesin e "Damarëve të shqyer të Amerikës Latine", ka mundësi që Galeano do të kishte mbetur në një rreth të vogël të respektuar njohjeje, sikur të mos kishin qenë shkrimet e tij futbolistike. Në Itali e kanë kujtuar në fund sidomos prej tyre. Galeano, kanë thënë pakashumë, ishte ai gazetari i madh sportiv që rastësisht kishte shkruar edhe një bestseller të së Majtës tribotiste.

Por këtu vijmë tek gjysmë e vërteta e tretë. Galeano ishte i majtë? Subjektivisht, po. Nga një familje aristokrate e rënë nga vakti për të të cilën qe shtrënguar qysh fëmijë të punonte, kishte bërë jo vetëm punëtorin, mekanografin, arkëtarin dhe fatorinon, por edhe piktorin e dizenjatorin. Në moshën 14 vjeçare ia kishte shitur karikatyrën e tij të parë një të përjavshme të Partisë Socialiste.

Bashkëpunëtor i së përjavshmes së majtë "Brecha", azilant pas grushtit të shtetit të vitit 1973, mbështetës i regjimit kubanez, por kritik në vitet e fundit ndaj shfryrjeve periodike represive, vetë ai deklarohet mbështetës i një modeli marksizmi ortodoks, por tolerant ndaj diferencave ideologjike, që futej nën egjiden intelektuale e Rosa Luxemburg.

Mbështeti edhe Chávez dhe një prej pozicionimeve politike më të fundit të tij ka qenë në favor të Maduro në protestën ndaj Shteteve të Bashkuara pse e kishte shpallur Venezuelën si "kërcënim". Ama thoshte edhe se aksi me Iranin e "befasonte". I varrë më 1967 Che Guevara, i dalë më 1968 "100 vjet vetmi" i Gabriel García Márquez, i varrë më 1973 Salvador Allende, "Damarët e çarë të Amerikës Latine" doli më 1971. Thuajse në mes midis këtyre datave epokëndarëse, thuajse për të shpjeguar se pse Kontinenti martir ishte Krishti sakrifikes i revolucionit botëror.

Botimi italian i tij i vitit 1997 ka një parathënie ku Isabel Allende rrëfen sesi në largimin nga Kili si refugjate prej diktaturës së Pinochet kishte marrë me vete vetëm "disa veshje, fotografi të familjes, disa grushta dhe nga toka e kopshtit tim dhe dy libra: një botim të vjetër të "Odeve" të Pablo Neruda dhe librin me kopertinë të verdhë. "Damarët e shqyer të Amerikës Latine".

Por çfarë shkruan 31 vjeçari Galeano për poetin kilian që pikërisht në atë 1971 merrte Nobelin për Letërsinë? Citojmë nga shënimi 45 pikërisht nga ky botim italian i vitit 1997. Referimi është për José Gaspar Rodríguez de Francia, diktator i Paraguajit nga 1814 deri më 1840. Në këtë rast,

termi diktator ishte pikërisht ai që i ishte dhënë zyrtarisht.

"Francia përbën një prej shembujve më të pabesueshme të kafshërisë si historisë zyrtare. Deformimet e bëra nga liberalizmi nuk janë prerogativë e klasave dominuese në Amerikën Latine: edhe shumë intelektualë të majtë, të mësuar që ta shohin historinë e vendit të tyre me sytë e të tjerëve, ndajnë mite të caktuar të së djathtës dhe ia miratojnë kanonizimet dhe shkishërimet.

"Canto general" i Pablo Neruda (Buenos Aires 1955), homazh i mrekullueshëm poetik ndaj popujve latinoamerikanë, është një shembull i qartë i këtij çorientimi. Neruda injoron Artigas dhe Carlos Antonio e Francisco Solano López: në këmbim, identifikohet me Sarmiento. E quan Francia "mbret lebroz, i rrethuar / nga kullota të pafundme", që e "mbylli Paraguajin si fole / për madhërinë e tij" dhe "lidhi / torturë e baltë me "kufijtë". Me Rosas sigurisht që nuk është më dorëlibër: faktikisht, sokëllin kundër "grushtave, të lëshuara si kallinj mbi martirin e një "Argentine të vjedhur me të shtëna pushkësh / në avullin e mëngjesit, e ndëshkuar / deri në gjak dhe deri në çmenduri, / bosh, e kalëruar nga kapadinj të vrazhdë".

Neruda i çorientuar? Galeano djalë i keq mendjemadh? Problemi është shumë më kompleks dhe vendimtar. Komunist nga fundi i viteve '30, senator më 1945, në ekzil midis viteve 1948 e 1952 si pasojë e ndalimit të Partisë Komuniste Kiliane, kandidat i po kësaj partie në primaret e Unidad Popular që do të çonin më 1970 në zgjedhjen e Allende, Neruda ishte ai që mund ta quanim togliatian.

Domethënë, një ndjekës i kësaj linje të komunizmit ortodoks prosovjetik të viteve '40 e '50 tipike e partive të mëdha komuniste të vendeve perëndimore, që e konsideronin veten trashëgimtare të revolucioneve "borgjeze" dhe përgjithësisht të traditës iluministe. Është ky motivi për të cilin i emërtonte me Garibaldi formacionet e tij të armatosura dhe shikonte deri nga e djathta historike dhe Partia Komuniste Franceze ekzaltonte Revolucionin Francez në variantin jakobin të tij. Në një Amerikë Latine ku Domingo Faustino Sarmiento i kishte lexuar luftërat civile të '800 si larje hesapesh midis një "partie europiane" liberale dhe një "partie amerikane" reaksionare, partitë komuniste latinoamerikane dhe Neruda prezantoheshin në linjën e "partisë europiane". Dhe "Canto General" celebron pikërisht këtë qasje.

Por me "teorinë e varësisë" lloji i politikës që patën bërë liberalët e Tetëqindës faktikisht vihet në gjykim. Ndërsa në vitet Tridhjetë e Dyzet në Europë fashizmi i shtynte partitë komuniste në frontet popullore dhe në komitetet e çlirimit, në Amerikën Latine qenë pikërisht lëvizjet populiste e frymëzuar nga fashizmi ato që organizonin masat shpesh në mënyrë më efikase se komunistët: nga argentinasi Perón tek braziliani Vargas, duke kaluar tek peruani Haya de la Torre.

Të frymëzuar nga fashizmi, të jemi të qartë: jo fashistë. Fashistët doc, sidomos të persekutuar nga Vargas në Brazil, nuk arrinin të kishin sukses për shkak të identifikimit të tyre të tepruar me një model të huaj. Paksia si vetë komunistët. Në këtë kuptim, modeli mussolinian


shërbente si reagent me një traditë më të lashtë kaudiliste të "partisë amerikane", në një mënyrë që nga aty e pak më vonë do të kërcente edhe majtas.

Kastrizmi është pikërisht një rezultat i këtij udhëkryqi ku marksizmi në praktikë kalon nga partia europiane në partinë amerikane, duke u infektuar me nacionalizëm dhe populizëm. "Damarët e shqyer të Amerikës Latine" shërbejnë për ta rishkruar historinë sipas kësaj perspektive të ndryshme: tiranët e vjetër dhe diktatorët e demonizuar nga liberalët bëhen heronj të antiimperializmit dhe janë liberalët që demonizohen si kuaj Troje të të huajit.

Por historia është më komplekse. Vetëm për të bërë tri saktësime midis mijërave që "Damarët e shqyer të Amerikës Latine" do të meritonin: Francia dhe Rosas në realitet qenë armiq midis tyre; liberalët meksikanë qenë në vijën e parë të luftës kundër ndërhyrjes së huaj; së fundmi, pse në rivlerësimin e kaudilosve të Tetëqindës të demonizuar nga Neruda Galeano harron ekuadorianin García Moreno? Vetëm pse ishte një ultraklerikal absolutisht i parikuperueshëm ndaj çdo imagjinate të majtë?

Por ky është një debat i mëtejshëm. Duke u kthyer tek Galeano: realiteti është se Neruda ishte një togliatian rilindas, ai ishte ekuivalenti i një neoburboni. Një që sikur të kishte folur për historinë italiane do të përfundonte duke i quajtur të 1000-ët e Garibaldit si agjentë të imperializmit dhe do ta quante hero antiimperialist Françeskun e II e Dy Siçilive.

(Maurizio Stefanini për Limes)  
Përgatiti: ARMIN TIRANA





# Gjithçka filloi nga një poezi ...

Nga: Flutura ORUQI


Më shumë se pesëmbëdhjetë vite më parë, libri "Bohemian New Orleans" i Jeff Weddle-it, sado e çuditshme që mund të duket, gjeti rrugën drejt këtij vendi të vogël, të shkatërruar nga lufta në Evropën Juglindore, të quajtur Kosovë. Ky libër, i cili prej shumë vitesh është pjesë e bibliotekës personale të Fadil Bajrajt, flet për një shtëpi të vogël botuese që tërhoqi vëmendjen si botues i parë i Charles Bukowski-t, dhe nuk është rastësi që përkthyesi i parë i Bukowski-t në shqip, Fadili, kishte hasur në të.

Fadil Bajraj, një përkthyesi i njohur i letërsisë anglo-amerikane, është personi përgjegjës për prezantimin e poetëve të Brezit Bit te lexuesit shqiptarë gjatë viteve tetëdhjetë. Në fakt, Bitët u bënë të njohur brenda një grupi të vogël lexuesish në Kosovë gjatë viteve nëntëdhjetë, veçanërisht me botimin e revistës voluminoze letrare "MM" në vitin 1997. Në atë kohë unë studioja letërsi në Universitetin e Prishtinës. Vendi ishte në prag të luftës, kështu që unë dhe miqtë e mi mbledheshim shpesh në shtëpinë e prindërve të mi për të shkëmbyer libra dhe shënime. Ngandongjëherë lexonim poezi, shpesh poezi patriotike. Më kujtohet hera e parë kur ua prezantova revistën MM dhe fillova të lexoja disa nga poezitë e Ginsberg-ut. Mbetem pa fjalë. Mes shumë kontradiktave që karakterizojnë Ginsberg-un, për ne, ishte hera e parë që fjalët: penis, vaginë dhe bythë ishin pjesë e diskursit poetik dhe sado vulgare të konsideroheshin, ato nuk e vulgarizonin poezinë. Kjo ishte diçka e re për ne dhe pavarësisht se sa befasuese ishte për ne prezenca e atij lloj fjalori në një revistë të tillë prestigjioze, në të njëjtën kohë ishte gjithashtu një përvojë e jashtëzakonshme, një përvojë iluminuese. Mendoj se kjo përvojë ilustron disi atë që Bob Marley i referohet si "emancipim nga skllavëria mendore".

Duhet të kemi parasysh se në atë kohë ne ishim skllavër të mentalitetit provincial ku mes shumë paradigmeve ishte edhe kjo: atdheu vetëm lavdërohet, nuk kritikohet. Ishin përkthimet e Fadil Bajrajt që ndryshuan përgjithmonë perceptimet tona për botën, jetën dhe mbi të gjitha poezinë. Po ashtu, më duhet të përmend se në atë kohë u botua antologjia e parë e poezisë rok në gjuhën shqipe e përkthyer nga Fadili.

Për brezin tim, kontakti me këtë lloj letërsie ishte diçka që zhvlerësonte gjithçka që kishim mësuar nga librat mbi teorinë letrare. Mbjaj mend që Fadil thoshte se është vetëm çështje kohe kur poezia rok do të përfshihet në kurikulat universitare.

Viti 2016 e dëshmoi këtë. Bob Dylan fitoi Çmimin Nobel për



Letërsi. Nga një brez që ishte rritur i shtypur, ne u shndërruam në një brez mendjehapur dhe që i thotë gjërat troç. Ishim me dhjetëra, na quani ndjekës ose dishepuj, qyshdoqoftë, që ndikoheshim drejtpërdrejt nga qëndrimet jokonvencionale të Fadilit. Ai ishte gurua ynë, "hipsteri ynë me kokë engjëlli". Ai na inkurajonte të kishim mendimet tona për letërsinë, artin dhe politikën. Ai na thoshte shpesh "Ginsberg dhe Bitët, Pound dhe shumë shkrimtarë të tjerë ndryshuan Amerikën dhe botën. Jo bomba atomike!"

Fadili ka studiuar Gjuhë dhe Letërsi Angleze në Universitetin e Prishtinës, por së shpejti flokët e tij të gjatë, palltoja ushtarake që të përkujtonte Ian Curtis-in dhe xhinset e grisura do të tërhiqnin vëmendjen e profesorëve të tij, duke çuar në shumë mosmarrëveshje të cilat rezultuan që ai të braktis Universitetin. Duke u larguar nga fakulteti ai bëri një akt të paprecedentë: pshurri mu në hyrje të Universitetit në mes të ditës. Ai nuk u kthye më atje deri në ditën kur unë diplomova, rreth 30 vjet më vonë.

Të kthehem te libri "Vritmë nëse ke koqe". U deshën pothuajse dy dekada që emri i Jeff Weddle-it të rishfaqej në bisedat e mia me Fadilin kur ai përktheu dhe botoi poezinë e Jeff-it "Manifesti". Më bëri përshtypje guximi i këtij shkrimtari. Menjëherë i shkrova Fadilit: kush është Jeff Weddle? Ai më shpjegoi se Weddle është autori i "Bohemian New Orleans", dhe unë isha ajo që e kisha sjellë personalisht librin në Kosovë. E kisha harruar. Kishin kaluar pothuajse dy dekada, megjithatë ende mbaja mend emrat Gypsy Lou dhe Jon, themeluesit e LouJon Press-it për të cilët edhe bëhej fjalë në libër ngase i kisha lexuar të gjithë librat me letrat e Bukowskit. Edhe

pse disi z. Weddle më kujtoi Ginsberg-un dhe Bukowsk0in, dy shkrimtarë krejtësisht të ndryshëm, ai nuk i ngjan asnjërit prej tyre. Ajo që më bëri më shumë përshtypje përveç stilit të tij ishin pikëpamjet e guximshme politike, metaforat e pazakonta dhe shkrimi i tij përgjithësisht autentik.

Fadili kontaktoi z. Weddle përmes Facebook-ut dhe së shpejti z. Weddle do t'ia dërgonte të gjithë librat e tij Fadilit në Kosovë. Fadilit i pëlqyen librat, i përkthente poezitë dhe m'i dërgonte pothuajse çdo ditë nga një ose dy poezi, dhe në fakt aty na lindi ideja për botimin e kësaj përmbledhjeje. Poezitë e tij ngjasonin me realitetin tonë politik dhe shoqëror në Kosovë sado të ndryshme dhe të largëta ishin vendet tona. Siç thashë më parë më bëri përshtypje elementi patriotik në poezinë e tij; më kujtoi Ginsberg-un. Por, më së shumti më bëri përshtypje shqetësimet e tij të shprehura në të gjithë librin për të ardhmen e vendit të tij dhe krizat me të cilat po ballafaqohet shoqëria amerikane. Rritja e dhunës dhe krimin në familje, rritja e dallimeve racore, sociale dhe kulturore, dallimet e thella politike janë vetëm disa nga temat e trajtuara në këtë libër. Njerëzit që po mbajnë gjurin në fyt të Amerikës janë të njëjtët njerëz që u rritën duke u zotuar për besnikëri ndaj Flamurit dhe Republikës: për një komb të pandarë.

Nëse Fadili e mësoi atdashedashurinë nga Bob Dylan, siç thotë në një nga intervistat e tij të rralla, unë disi e mësova nga Ginsberg-u. Patriotizëm, në mes tjerash është edhe atëherë kur kritikoni abuzimin e pushtetit politik nga ata në qeveri, edhe atëherë kur kërkoni llogaridhënie nga qeveria e juaj, e edhe atëherë kur kërkoni përgjegjësi dhe drejtësi institucionale.

"I pashë mençurakët më të mirë të

brezit tim të shkatërruar nga çmendia", vargu i parë i Ulërimës duket më i rëndësishëm sot se kurrë. Sot po përballemi me kohë edhe më demonike. Sipas Jeff Weddle-it Amerika nuk duket se ka mësuar shumë nga kritikantët e Ginsberg-ut dhe veçanërisht ky qëndrim këmbëngulës dhe megaloman i qeverisë amerikane është kritikuar në shumë poezi që përfshihen në këtë përmbledhje. Duke qenë një kritik i madh i lidershipit republikan, poezia e z. Weddle zhvesh qëllimisht mitin amerikan dhe ekspozon ëndrën amerikane. Ëndrra amerikane po shndërrohet në makth amerikan: Gjaku është i lirë kur derdhet nëpër botë ndërsa gjaku i njerëzve këtu është problem sall kur ankohe mi (Shikoni së pari Amerikën). Amerika e rinisë së tij ka marrë fund. Hendeku midis të pasurve dhe të varfërve po zgjerohet çdo ditë. Si kudo në botë, pjesa më e cenueshme e shoqërisë vuan pasojat derisa dikush po përfiton nga kjo situatë. Me fjalë të tjera, poezia e tij është një kundërshtim i kësaj politike që po e tërheq Amerikën drejt një të ardhmeje të pasigurt. Nëse Amerika do të shkatërrohet ndonjëherë, ajo do të vijë nga brenda, dhe ky është mesazhi për të cilin z. Weddle na paralajmëron: "Amerikën që e kam dashur, që i ka dhënë dritë viteve të mia, a ka mbaruar drita jote tash?" (Situata).

Ka shumë për t'u thënë për këtë libër.


Janë gati 300 faqe proteste, kritika, zemërimi, zhgënjimi, shprese, madje edhe dashurie. Nëpërmjet këtij libri, ju bëheni pjesë e një tabloje më të madhe, autori ju fton brenda purgatorit të tij, ku mund të hidhni një vështrim në jetën e përditshme të individit në jug të Shteteve të Bashkuara dhe të zbuloni të vërtetën e qytetarit amerikan, e cila në njëfarë mënyre

është e ngjashme me atë të qytetarit kosovar: të gjithëve na ka zezuar qeveria dhe "Historia jonë tash/rishkruhet përditë/ me drejtshkrim të dobët/ dhe gramatikë të keqe." (Plakja)

Edhe pse ky libër në mënyrë pothuajse kronologjike paraqet ndikimin e zhvillimeve politike në shoqëri, veçanërisht në këto vitet e fundit, kur politika amerikane tronditi botën, përmban edhe një sërë poezish për dashurinë. Disa nga poezitë e tij më të bukura dhe emocionale i kushtohen gruas së tij Jill. Është bukur kur dikush i nënshtrohet dashurisë: "Ti m'je bashkudhëtare/ e ëndrrave të mia/ misteri im më intim." (Të gjitha rrugët) dhe kur deklaron: "Jam i gatshëm për dhimbjen tënde/ jam i gatshëm/ jam i gatshëm për gjithçka" (RSVP) dhe frika se humbja e dashurisë mund të jetë fatale "Përgatite zemrën tënde për zgavra. /ato vijnë goxha shpejt/ dhe nëse do të të humbas/ një gjë e tillë do të më mbyste." (Më përkujto si të jem njeri) janë vetëm disa nga poezitë që shpalosin anën intime të autorit të shprehur me një tonalitë skajshmërisht të ndjeshëm. Dhimbja e tij nuk është më vetëm e tij, ajo tashmë është bërë edhe dhimbja jonë dhe edhe pse të gjithë po jetojmë në një kohë "kur engjëjt çmenden nga keqardhja" (Gënjeshtra e madhe) poezitë e Jeff Weddle-it na rikthejnë besimin e humbur te njerëzimi "përpikuni ta bëni botën më të mirë/...kjo është dhurata që ti sjell/ kjo është arsyeja pse je ti këtu (Prandaj).

Para disa vitesh Fadili solli një tjetër autor amerikan në gjuhën shqipe, Dan Fante, me librin e tij "Heshtja e poetit është një akt terrorist". Jeff Weddle është një tjetër poet amerikan që nuk hesht. Madje ai shkon edhe një hap më tej, atyre që nuk i pëlqejnë të vërtetat e tij, u bërtet: Vritmë nëse ke koqe. /Telegrafi/





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Kampionati Evropian U17 do të zhvillohet në Shqipëri

**TIRANË, 26 SHTATOR** - Federata Shqiptare e Futbollit ka arritur një tjetër sukses historik, duke sjellë për herë të parë në Shqipëri finale të një turneu madhor ndërkombëtar për moshat. UEFA ka vendosur t'ua besojë FSHF-së dhe Shqipërisë mikpritjen e finaleve të Kampionatit Evropian 2025 për

grupmoshën U-17. Federata Shqiptare ishte një nga federatat që kishte kandiduar për ta pritur fazën finale të turneut, duke përgatitur një aplikim voluminoz që u përgatit nga administrata e FSHF-së dhe që më pas u paraqit në UEFA. Së fundmi, Komiteti Ekzekutiv i UEFA-s në mbledhjen e zhvilluar këtë

të martë në Qipro ka votuar për kandidaturën shqiptare, me finale të turneut kontinental që do të luhen në Shqipëri pas dy vjetësh. Investimet në infrastrukturë me stadiumet e reja, që plotësojnë kriteret e duhura për turne ndërkombëtarë, apo edhe përvoja e pasur e administratës së FSHF-së për

mikpritjen dhe organizimin e turneve ndërkombëtarë, e ka bindur sërish UEFA-n të sjellë në Shqipëri një ngjarje madhore. Në Shqipëri majin e vitit 2022 u organizua finalja e parë e Ligës së Konferencës, AS Roma-Feyenoord, një ngjarje historike për Shqipërinë dhe futbollin shqiptar. Tani është momenti për një tjetër ngjarje



të rëndësishme, që do t'i sjellë kombëtarët më të forta të kontinentit për të luftuar për trofeun e titullit kampion Evropë.

## Katër ndeshje evropiane të hendbollit zhvillohen në Kosovë

**PRISHTINË, 26 SHTATOR** - Plot katër ndeshje të Kupave Evropiane do të luhen në fundjavë në Kosovë. Behet fjalë për ndeshjet e raundit të dytë të Kupës Evropiane (EHF European Cup) për hendbolliste. Kampioni në fuqi, Istogu, do të përballet me skuadrën nga Portugalia, SIR 1Maio/Ada CJB. Të dyja ndeshjet luhen në palestrën "Karagaçi" në Pejë për shkak të gjendjes jo të mirë të palestrës në Istog. Ndonëse ishte premtuar, renovimi i palestrës në Istog nuk është bërë ende dhe KHF Istogu është detyruar të zhvendoset në Pejë. Në Istog ishin planifikuar edhe ndeshjet e Përfaqësues A dhe aktivitete të tjera të përfaqësuesve që, po ashtu, do të mbahen në qytete të tjera. Ndeshja e parë e Istogut

është të shtunën prej orës 18:00, ndërsa ndeshja e dytë është të dielën prej orës 18:00. Istogu ka fituar Superkupën kohë më parë dhe është i gatshëm për ndeshjet evropiane. Priten dy ndeshje të forta dhe interesante. Me marrëveshje mes dy klubeve, dy ndeshje në shtëpi i zhvillon edhe KHF Ferizaj. Ferizajaset përballet do ta kenë skuadrën nga Izraeli, Maccabi Arazim Ramat Gan. Ndeshja e parë është të shtunën prej orës 20:15 në palestrën "Bill Clinton". Në të njëjtën arenë të dielën prej orës 19:00 është ndeshja e dytë. Ferizaj ka angazhuar shumë lojtare të huaja dhe është konsoliduar për kampionatin e ri. Njëjtë si Istogu, synon suksesin në Kupën Evropiane.



## Duka zgjedhet zëvendëspresident i UEFA-s



**TIRANË, 26 SHTATOR** - Presidenti i FSHF-së, Armand Duka, nga dita e martë do të jetë edhe në pozitën e zëvendëspresident i UEFA-s, duke u bërë i pari shqiptar që arrin në një pozicion kaq të lartë në hierarkinë e futbollit evropian. Vendimi u mor në mbledhjen e radhës të Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s që zgjodhi pikërisht Dukën me votim unanim në pozitën e numrit dy të qeverisë së futbollit evropian. Një vendim që vjen natyrshëm duke parë kontributin e madh ndër vite të presidentit të FSHF-së dhe përvojën e tij të vyer në menaxhimin e futbollit tashmë edhe në Evropë. Një tjetër

votëbesim i rëndësishëm për numrin një të futbollit shqiptar, që pak muaj më parë u zgjodh për herë të dytë anëtar i Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s në Kongresin e 47-të të UEFA-s që u zhvillua në Lisbonë, Portugali. Në këto zgjedhje Duka arriti një rekord teksa u rendit në vendin e parë në bazë të votave, si më i votuari, duke u zgjedhur me 45 vota në total nga 55 të tilla dhe duke marrë kështu për herë të dytë besimin e delegatëve të shumë federatave të mëdha evropiane. Ky lajm është pa diskutim një arritje e madhe jo vetëm për futbollin shqiptar, por për të gjithë Shqipërinë.

## Rrahmani: Do të festoj me shqiptonjë sa herë të më jepet rasti

**Bukuresht, 26 shtator** - Sulmuesi nga Kosova, Albion Rrahmani, ishte protagonist i Rapid Bukureshtit mbrëmë në fitoren 3-1 ndaj Clujit. Sulmuesi "dardan" realizoi dy gola dhe e bëri një asistim. Pas golit të dytë, Rrahmani festoi duke e

formuar me duar shqiptonjë, simbolin e shqiptarëve. E rumunët e kanë pyetur ish-futbollistin e Malishevës dhe të Ballkanit për festimin e tij dhe për domethënien e tij, ndërsa 23-vjeçari ishte i qartë në përgjigje. Madje ai nuk e ka

ndërmend të ndalet në këtë aspekt. "Unë jam nga Shqipëria, saktësisht nga Kosova. Kam luajtur atje. Gjaku im është shqiptar dhe dua t'i inkurajoj shqiptarët gjithmonë kur kam mundësi", ka deklaruar Rrahmani për mediet

rumune. Ai i ka realizuar 6 gola në 4 ndeshje me ekipin rumun, të cilit iu bashkua gjatë verës nga Ballkani. Nëse vazhdon me këtë formë, Rrahmani mund të transferohet në një klub më të madh evropian gjatë verës së ardhshme.





## 'The Sun': Grabitësi i banesës së Sterlingut fshihet në Shqipëri

LONDËR, 26 SHTATOR - Një prej të dyshuarve në kërkim për grabitjen e një shume prej 300 mijë paundësh në shtëpinë e yllit anglez të Chelseat, Raheem Sterling, është në arrati në Shqipëri. Të dhënat tregojnë se Henri Osmani, 44-vjeçar, ka hyrë

në Shqipëri me datë 18 korrik. Policia shqiptare, shkruan "The Sun", ka bashkuar forcat me policinë angleze për ta gjetur personin në fjalë. Ministri i Brendshëm i Shqipërisë, Taulant Balla, ka thënë për "The Sun": "Asnjë

shqiptar i përfshirë në krime në Mbretërinë e Bashkuar nuk duhet të mendojë se vendi ynë është një vend ku mund të fshihesh". Grabitësit e tjerë shqiptarë, Alfred Isufi, 48 vjeç dhe Gerard Kalaja, 22 vjeç, janë në arrati, por jo në Shqipëri.

Grupi i grabitësve shqiptarë është i lidhur me 33 vjedhje në Surrey, Essex, Kent dhe Herts. Grabitja e banesës së sulmuesit anglez ndodhi në periudhën kur ai ishte i përfshirë në Kupën e Botës në Katar me kombëtaren e tij të Anglisë.



## Asani: Pa Sylvinhon nuk do të isha këtu

TIKANË, 26 SHTATOR - Jasir Asani, i cili aktivizohet në Korenë e Jugut, ka folur për shumë tema nga kombëtarja, merkato, si dhe raportin me Ernest Muçin. Asani ka theksuar se ai dhe Muçi do të rikthehen sërisht një ditë në Superiore për ta sfiduar sërisht njëri-tjetrin në derbin Partizani - Tirana si në kohët e vjetra. "Isha edhe në Hungari, te Kisvarda. Kam bërë një sezon shumë të mirë me shumë gola. Ishte sezoni i parë në Evropë. Në ndeshjet evropiane të Ligës së Konferencës me Kisvardën ku kemi luajtur ndaj Kairat dhe Molde kam bërë ndeshje të mira, kam shënuar edhe gol. Kisha ofertë zyrtare nga Molde pas ndeshjes, por presidenti i Kisvardës nuk më la të largohesha sepse po kaloja mirë. Trajneri Moldes mesa kisha dijeni e kishte shok Zabaletën dhe Sylvinhon dhe kanë folur që para se të vinte Sylvinho në kombëtare. Pastaj më kanë ndjekur. Është e vështirë në kombëtare kur vjen nga jashtë Evropës, por gjithsesi unë i jam falënderues Sylvinhos pasi pa të dhe stafin e tij nuk do të isha në kombëtare", ka thënë Asani, i cili ka shtuar se aventura në Korenë e Jugut me Gwangu është ndryshe nga Evropa: "Që ditën e parë kur kam ardhur është shumë ndryshe



nga Evropa, është pak e vështirë për t'u ambientuar. Dy-tre muajt e parë ishin të vështira me kohën dhe ushqimin, ndryshimi i orarit. Njerëzit janë të dashur dhe më kanë dhënë besim. Jemi në vend të tretë. Kemi edhe dy ndeshje, pastaj luajmë 'play-off' për të përcaktuar se kush do të jetë kampion. Duam të luajmë edhe në Championsin e Azisë".

I pyetur se cili është goli më i bukur me kombëtaren, ai ndaj Moldavisë apo ai ndaj Polonisë, Asani ka deklaruar: "Të dy golat kanë qenë të rëndësishëm për mua sepse ishin ndeshjet 0-0, por ndaj Polonisë është goli më i mirë në karrierën time. Luanim ndaj një kombëtare shumë të fortë, por arritëm të fitojmë dhe të tregojmë se

kombëtarja po bën gjëra të mëdha dhe kemi edhe ndeshje të vështira. Kemi ndeshjen e radhës dhe duhet të fokusohemi atje. Është ndeshja e jetës. Të marrim një fitore dhe të kualifikohemi për në Gjermani. Po pres. Kam disa oferta dhe janë katër-pesë skuadra që më pëlqejnë, por flet menaxheri. Ëndrra është të luaj në një kampionat të madh evropian. Një ditë do të doja të rikthehesha në Shqipëri te Partizani. Tani për tani jam në momentin më të mirë të karrierës dhe dua të luaj në një ekip të madh evropian. Jam i fokusuar te ndeshjet e radhës dhe duhet të fitojmë që të shkojmë në Champions të Azisë", ka shtuar Asani.

Në fund ylli i kombëtares së Shqipërisë foli edhe për shokun e tij, futbollistin Ernest Muçi. "Muçin e kam shumë shok edhe në kombëtare. Është një lojtar shumë i mirë. Është një talent. Do të na bëjë shumë punë se ka kualitete. Do t'i vijë shpejt rasti se po bën mirë me Legjan dhe besoj një ditë do të kemi sërisht derbi në Tiranë. Kontakti me Muçin në një derbi në mes të Tiranës dhe Partizanit? Arbitri nuk dha penallti. Do të thotë se nuk ka pasur faull. Nuk ka pasur VAR atëherë", u shpreh Asani.

## Ish-kampioni i botës drejtoi veturën e dehur, rrezikon 3 muaj burg

WELLINGTON, 26 SHTATOR - Ish-kampioni i botës në peshën e mesme në artet marcialë mikse, Israel Adesanya, është deklaruar fajtor për akuzat, për drejtim të mjetit në gjendje të dehur. Ngjarja ka ndodhur në vendlindjen e tij, në Zelandën e Re. "Dua t'i kërkoj falje komunitetit, familjes sime dhe ekipit tim për vendimin që mora për ta marr timonin e makinës pasi piva në një darkë", ka thënë Adesanya në një deklaratë të dhënë për ESPN. "Jam i zhgënjyer me vendimin tim për ta drejtuar makinën. Ishte vendim i gabuar. E di që njerëzit mund të më ndjekin dhe dua që ata ta dinë se nuk mendoj se kjo sjellje është e pranueshme", ka shtuar ish-kampioni i botës në UFC, tashmë



34 vjeç. Ngjarja ka ndodhur më 19 gusht të këtij viti, kur Adesanya u ndal nga policia rrugore dhe pas testit doli se kishte konsumuar shumë alkool, duke kaluar normat e lejuara. Ai po kthehej nga një darkë me miqtë kur u ndalua rastësisht nga policia në Auckland.

Luftëtari i MMA-së do të kthehet në gjykatë më 10 janar për ta marrë vesh dënimin. Ai mund të përballet me një gjobë deri në 2680 dollarë dhe/ose tre muaj burg. Adesanya humbi me vendim unanimit ndaj Sean Strickland në UFC-293, më 10 shtator, në Sidney.

### SHKURT

#### Tebas: Mbappe sezonin e ardhshëm do të jetë në La Liga

Presidenti i La Ligas, Javier Tebas, ka dhënë një intervistë për "Deporte Plus", në të cilën ka folur për çështjet aktuale që e shqetësojnë futbollin spanjoll në përgjithësi. Ndër të tjera, ai është ndalur edhe tek emri i sulmuesit francez Kylian Mbappe, ku gjasat janë ende që ai të firmosë për Real Madridin sezonin e ardhshëm. Edhe pse Tebas nuk ka përmendur ndonjë emër skuadre spanjolle, ai nënvizoi se shanset që Mbappe të jetë në Spanjë sezonin e ardhshëm janë të larta. "I bindur 100 % jo, asnjëherë nuk mund të flasësh me siguri të plotë. Por unë mendoj se vitin e ardhshëm Mbappe do të jetë në La Liga 70-80 % të shanseve", është shprehur Tebas.

#### Alonso, pasardhës i Ancelottit në Real

Xabi Alonso do të jetë trajneri i ri i Real Madridit në sezonin e ardhshëm. Pasi Carlo Ancelotti ta marrë drejtimin e Brazilit, tashmë duket se është vendosur për afrimin e ish-mesfushorit. Për 42-vjeçarin do të ishte një rikthim në Madrid. Ai ka luajtur në Madrid nga viti 2009 deri në 2014, madje në sezonin e tij të fundit me fanellën e bardhë (2013-14) kishte Ancelottin trajner. Spanjollit ka përfaqësuar "Los Blancos" në 236 ndeshje, duke fituar një Ligë të Kampionëve, një kampionat, dy Kupa Mbreti, një Superkupë të Spanjës dhe një Superkupë të Evropës. Këtë sezon Leverkuseni, që udhëhiqet nga Xabi Alonso, mban vendin e parë së bashku me Bayernin, duke zhvilluar një sezon të jashtëzakonshëm, teksa kujtojmë se në skuadrën e tij është edhe Granit Xhaka.

#### Thurami në 'radar' të Chelseat dhe Realit

Marcus Thuram e ka nisur në mënyrë të përkryer aventurën e tij tek Interi, duke bërë që të harrohet shpejt belgu Romelu Lukaku teksa tifozët zikaltrë e kanë tashmë atë si "beniaminin e ri". Sulmuesi francez u transferua tek Interi në verë me parametra zero, pasi i përfundoi kontrata me Borussia Monchengladbach, megjithatë nëse vijon me paraqitje të tilla, mund t'i lërë zikaltrit që në fund të sezonit. Chelsea dhe Realit i Madridit kanë nisur t'i përcjellin paraqitjet e 26-vjeçarit francez, pasi e shohin përforcim ideal, duke qenë se të dy klubet nuk kanë në organikë sulmues me peshë. Ndonëse është ende herët, bëhet fjalë për dy klube që mund të ofrojnë para mjaftueshëm sa të joshin Interin ta shesë francezin. Gjithsesi shumë do të varet nga ecuria e Thuramit, që duhet të sjellë konfirmime në të ardhmen.

#### Enrique: Emery është një futbollist i kompletuar

Trajneri i PSG-së, Luis Enrique, e ka lavdëruar mesfushorin 17-vjeçar Warren Zaire-Emery. Trajneri spanjoll e ka vlerësuar talentin në fjalë si një lojtar shumë i kompletuar. "Warren është një futbollist që duket sikur është 37-vjeçar, jo 17-vjeçar. Është një mundësi e shkëlqyer për mua që të kem një lojtar me cilësi të tilla. Ai luajti shumë me Galtierin sezonin e kaluar (31 ndeshje). Kënaqësi ta stërvitësh. E cilësoj si një lojtar shumë të kompletuar, shumë profesionist dhe një shembull. I përulur, punëtor i madh dhe profesionist në maksimum. Shumë inteligjent në fushë dhe që gjithmonë di të luajë me shokët e skuadrës", ka thënë Enrique.

## Balotelli, Milanit: Jam gati për të qenë sulmuesi yt

AC Milan ka mbetur gjithmonë në zemrën e Mario Balotellit. Sulmuesi italian nuk ka reshtur asnjëherë së dashuruari ngjyrat kuqezi që në fëmijëri. Ish-sulmuesi i

kombëtares italiane arriti ta përmbushë ëndrrën e tij për të veshur atë fanellë në sezonin 2013-14 duke shënuar 26 gola në 43 ndeshje. Megjithatë, gjatë një interviste Balotelli

hapi rrugën e një rikthimi të mundshëm në Milano. Balotelli është shprehur i gatshëm të jetë një zëvendësuesi i Giroudit në skuadrën e Piolit, duke u

vetëkandiduar nëse kuqezinjtë do të kenë nevojë. "A kishin nevojë për një sulmues? Ja ku jam! Problemi i Milanit është se rekruton lojtarë të rinj dhe më pas ata

duhet të konkurrojnë në 'San Siro', por ky stadium nuk është si të tjerët, duhen lojtarë me personalitet që të bëjnë më të mirën", është shprehur Balotelli.





NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE  
LOCAL PUBLIC ENTERPRISE  
NPL "KUZHINA QENDRORE" SH.A.  
PRISHTINË  
Nr. 0308 Dt. 27.09.2023

Ndërmarrje publike lokale | Rr. Egnatia p.n. - 10 000 Prishtinë | www.kuzhina.net | kuzhinaqendrore@gmail.com | tel: + 383 45 709 106

Në bazë të nenit 16.2 dhe 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: viti III/nr. 31/15 Qershor 2008), si dhe në bazë të nenit 6 të Ligjit nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe i plotësuar më ligjin nr. 04/L-111 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 07 maj 2015) Komisioni Komunal i Aksionarëve të N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A. në Prishtinë, me datën 27.09.2023, shpall këtë:

## KONKURS

**Pozita:** Një (1) Anëtare të Bordit të Drejtorëve të N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A. në Prishtinë ( nga gjinia femërore për shkak të përmbushjes së kuotës gjinore në pajtim me legjisllacionin në fuqi).

**I përgjigjet:** Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A. në Prishtinë.

**Mandati:** Tri (3) vite.

**Kompensimi:** Konform nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, dhe plotësim ndryshimeve përkatëse.

### 1. Të përgjithshme

Kandidatja për këtë vend pune duhet të jetë person me integritet, e cila i plotëson kushtet e kualifikimit dhe kriteret e pavarësisë, posedon përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, si dhe i plotëson kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe aktet tjera pozitive relevante.

### 2. Kushtet e kualifikimit profesional dhe përshtatshmërisë

Çdo kandidatë për t'u konsideruar në pozitën e Drejtorit të Bordit, duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë - së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit në fushat si vijon: në administrim të biznesit; - financa të korporatave; - financa; - menaxhim thesari; - banka; - konsulencë në biznes ose industri; ose - nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste - të ndërmarrjes; ose për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar- i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlihet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.

### 3. Pajtueshmëria

Konform ligjit në fuqi, një person nuk ka të drejtë të shërbejë si drejtor në Bordin e Ndërmarrjeve publike, nëse: a) Ka qene i/e dënuar nga një gjykatë kompetente, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë tjetër në bazë të ankesës; ka kryer vepër penale ose civile, vepër që përfshinë përgenjshtrimin, prezantimin e rrejshëm, korrupsionin, vjedhje, pastrimin e parave, përvetësimin, keqpërdorimin apo ndarjen e rrejshme të fondeve; ka qenë i/e përfshirë në mitosje apo rryshfet sipas ligjeve apo rregulloreve në fuqi në Kosovë apo ndonjë vend tjetër, apo sipas traktateve ose konventave ndërkombetare; b) është vendosur nga një gjykatë ose organ apo organizatë përgjegjëse për zbatimin e kodit etik apo standardeve të sjelljes profesionale, përveç nëse ky dënim ose vendim me pas është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër në bazë të ankesës (i) se është angazhuar në sjellje jo profesionale, (ii) se ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, (iii) se ka keq përvetësuar apo ka keqpërdorur parate apo burimet publike, (iv) se ka keqpërdorur apo keq-përvetësuar informatat (të dhënat) e fituara gjatë shërbimit si zyrtar publik apo shërbyes civil, ose (v) se ka keqpërdorur postin publik ose postin në shërbimin civil për përfitime personale ose për përfitime apo përparësi të një të afërmi ose të njohuri; apo; c) ka bërë përgenjshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim apo betimi tjetër, ose dokumenti të vulosur apo noterizuar; dhe d) është shpallur i falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara; e) punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrje Publike përkatëse ku kandidati punon.

**Të gjithë drejtorët duhet të jenë të pavarur. Nje person nuk konsiderohet i pavarur dhe nuk kualifikohet për zgjedhje si drejtor në një NP nëse:**

a) aktualisht është zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj, ose ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj brenda pesë (5) viteve të kaluara;

b) aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të lartë në NP-në përkatëse brenda tri (3) viteve të kaluara;

c) aktualisht ka, ose gjatë tri viteve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveq; si konsumator individual i shërbimeve të NP-së) me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;

d) është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;

e) pranon, ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara, kompensim shtesë nga NP përkatëse ose cilado nga filialet e saj (përveq; honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në

nenin 20.1 të ligjit primar, ose është anëtar në skemen pensionale të NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj;

f) mban drejtorësi të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së përkatëse përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe;

g) perfaqëson në aksionar i cili posedon dhjetë përqind (10%) të aksioneve votuese në NP-në përkatëse;

h) ka shërbyes në Bordin e Drejtorëve të NP-së përkatëse me shumë se nëntë (9) vite nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj; është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" në nenin 2 të ligjit primar i cilitdo person që i takon cilëso nga kategoritë më sipër përveç personit të përcaktuar në pikën (b); ose

i) është ose (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionari, ose ka një Interes Financiar në, një shoqëri tregtare të pa-listuar dhe që konkurron me Ndërmarrjen, ose (ii) menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy përqind (2%) të të drejtave të votimit) i, ose ka një Interes të konsiderueshëm Financiar në, cilëndo nga shoqëritë tregtare të listuara që konkurrojnë me Ndërmarrjen; dhe

j) është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;

k) ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktoje që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.

### 4. Dokumentacioni i nevojshem.

Kandidatët për drejtorë në Bordin e Drejtorëve konform këtij konkursi, duhet t'i dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

• Aplikacionin (merret në zyrën e ndërmarrjes ose në ëeb faqe të ndërmarrjes, [www.kuzhina.net](http://www.kuzhina.net))

• CV-në

• Letër motivimin

• Dëshmitë mbi kualifikimin profesional të noterizuar (Diplomat/Certifikatat dhe dokumente të ngjashme të marra jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara).

• Dëshmitë mbi përvojën e punës e vërtetuar me trustin pensional (Aplikacioni duhet të ofrojë të dhëna të sakta mbi periudhat e angazhimit dhe të korrespondojë me dokumentet vërtetuese).

• Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo me e vjetër se gjashtë muaj)

• Deklaratën nën betim (merret në zyrën e ndërmarrjes, ose në ëeb faqe të ndërmarrjes).

Me këtë dokument kandidati deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të nenit 17 të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 03/L-087. Çdo përgjeshtrim material - qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca - ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.

• Kopjen e letërnjoftimit

• Lista kontrolluese (merret në zyrën e ndërmarrjes, ose në ëeb faqe të ndërmarrjes).

### 5. Informata për procedurën e konkurrimit.

Konkursi do të jetë i hapur nga data 27.09.2023 deri me datën 12.10.2023: Dokumentacioni i aplikantëve mund të dorëzohet në arkivin e N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A. në Prishtinë, çdo ditë pune prej orës 8:00 - 16:00, ose nëpërmjet postes fizike; (në zarf të mbyllur) të adresuar: Për Komisionin Komunal të Aksionarëve të N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A. në Prishtinë - "Aplikacion për Drejtor Bordi".

Të gjitha dokumentet të paraqiten në kopje të noterizuara, ndërsa origjinali i tyre, do të kërkohet në fazat e më vonshme të përzgjedhjes. Informatat shtesë mund të sigurohen përmes e-mail adresës: [kuzhinaqendrore@gmail.com](mailto:kuzhinaqendrore@gmail.com). ose drejtpërdrejtë në arkivin e Ndërmarrjes. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren parasysh. Të gjithë formularët duhet plotësuar në tërësi, mos plotësimi i tyre dhe informatat e pasakta do të rezultojnë në diskualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.

Komisioni Komunal i Aksionarëve do të zhvillojë një procedurë të hapur /transparente dhe konkurruese, ku përzgjedhja do të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës, konform Ligjit në fuqi dhe pa asnjë lloj diskriminimi, për çka inkurajon në aplikim kandidatët:

- nga gjinia femerore,

- kandidatet nga të gjitha komunitetet e Republikës së Kosovës; si dhe

-kandidatët nga të gjitha kategoritë tjera me pak të përfaqësuar në institucionet/organet/organizatat e vendit.

NPL "Kuzhina Qendrore" Sh.A

Prishtinë, Dt. 27.09.2023





# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ENTER GROUP” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 811455345 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ENTER GROUP” D.O.O. od Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrB. 811455345 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “ENTER GROUP” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811455345 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arlind Bishtazhini nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme ekonomike “Kadri Kusari”.

- Shkelzen Kralani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesëm teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.

- Alfa Pharm SH.P.K shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 810830001 si dhe certifikatën e TVSH-së, me nr: 330203977.

- Veton Haliti, shpall te pavlefshme dëftesat e vitit të parë, dytë dhe tretë të shkollës se mesme të lartë “Arkitekt Sinani”.

- “Furteria Gashi”, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810550906, Mitrovicë.

- Arian Karakashi B.I, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 811503350.

- Drita Nimani, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore “Osman Rama”.

- AHB GROUP SH.P.K, shpall te pavlefshme certifikatën e Tvsh-së me numër: 330403022.

- Lule Milici shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike “Nexhmedin Nixha”.

- Blerton Miftari, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore “SHABAN IDRIZI”.

- Blina Karakashi, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës se 11 të shkollës se mesme “DR. XHELADIN DEDA”.

- Endrit Shabani, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore “MIGJENI”.

- Jeton Hamiti, shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 1 deri 9 te shkollës fillore “HARUN BEKA”, (Ish-shkolla “Bajram Curri”)

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumescdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



